REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**DREJTORIA JURIDIKE DHE INTEGRIMIT**

Nr. 2013/7 prot. Tiranë, më 20. 11 .2023

***Lënda:*** *Kthim përgjigje kërkesës për informacion.*

[redacted]
**Tiranë**

Në vijim të paraqitjes së *"Kërkesë për informacion"* nr. 2013/6 Prot. datë 08.11.2023, sa i përket vënies në dispozicionin tuaj të akteve;

1. Kopje (sipas origjinalit e depozituar në zyrën e arkiv-protokollit të AKEP) e dokumentit të procesverbalit të inspektimit nr. 58 datë 26.09.2023).
2. Kopje (sipas origjinalit e depozituar në zyrën e arkiv-protokollit të AKEP) e dokumentit të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues datë 12.10.2023).
3. Kopje (sipas origjinalit e depozituar në zyrën e arkiv-protokollit të AKEP) e dokumentit të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues datë 24.10.2023).
4. Kopje (sipas origjinalit e depozituar në zyrën e arkiv-protokollit të AKEP) e vendimeve nr. 5; 8; 12 dhe 13,

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, përcjell bashkëngjitur kopje të dokumentacionit në fjalë.

Lidhur me informacionin e kërkuar në pikën katër të kërkesës së lartpërmendur, Ju bëjmë me dije se vendosja e penalitetit gjobë ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Albania sh.a., është kryer bazuar dhe në përmbushje të përcaktimeve ligjore shprehur në nenin 137 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008, *"Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KRYETARI**

[redacted]

AKEP
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë
Tel.: +355 4 2259 571 Fax: +355 4 2259 106
www.akep.al Email. info@akep.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**DREJTORIA E MONITORIMIT, KONTROLLIT DHE INSPEKTIMEVE**

# PROÇESVERBAL INSPEKTIMI

*"Për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike"*

Nr. **58** Datë. **26.09.2023**

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar (ligji 9918) nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" si dhe Rregulloren nr.46, date 27.10.2016 "*Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike*", mbahet ky procesverbal inspektimi i programuar midis Grupit të Inspektimit të AKEP dhe sipërmarrësit të inspektuar "One Albania" Sh.a.

## I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

***Emri i sipërmarrësit***: "One Albania" Sh.a ***Nipt*** J61814094W

***Adresa/vendndodhja***: Rruga "Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21, Tiranë.

***Emri i përfaqësuesit ligjor të sipërmarrësit***: z. Brano Durovic.

***Kohëzgjatja e inspektimit***: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

10.00 am, 29.08.2023 — (ora, data e fillimit)

10.00 am, 27.09.2023 — (ora, data e përfundimit)

***Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t):*** Selia e sipërmarrësit ne adresën: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë si dhe godinat ku ndodhen pajisjet teknologjike.

***Njoftim paraprak lënë sipërmarrësit:*** Po x ;

***Inspektim me autorizim:*** Po x ;
*(N.q.s. jo, do zgjidhet nga sistemi një nga germat e nenit 27, pika 2, të ligjit 10 443)*
***Lloji i autorizimit***: autorizim i posaçëm: Po x;

***Prezenca e përfaqësuesit ligjor të sipërmarrësit të inspektimit:*** Po x;

Gjatë procesit të inspektimit sipërmarrësi i komunikimeve elektronike objekt inspektimi, "One Albania" Sh.a., u përfaqësua me autorizim nr. 3973/1 prot, datë 12.09.2023 nga znj. Loreta Pistojla, të cilës iu dorëzua kopje e Autorizimit të Inspektimit të AKEP Nr. 2005, datë 29.08.2023 si dhe iu kërkua që grupit të inspektimit t'i krijoheshin kushtet e nevojshme për kryerjen e inspektimit, në përputhje me Rregulloren Nr. 46, datë 27.10.2016 *"Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike"*.
***Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:*** Jo x;

*(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit dhe të ketë hapësirë për ngarkim dokumenti shpenzimi);*

***Përjashtimi i përfaqësuesit të sipërmarrësit të inspektimit:*** Jo x;
*(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë);*

***Masa urgjente:*** Jo x;
*(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm në sistem);*

## II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. ***Mostra të marra:*** Po x;
*(n.q.s. Po më poshtë do të gjenerohet nga sistemi tabelat e mëposhtme në varësi të Inspektoratit Shtetëror përkatës);*

## TABELA E MARRJES SË MOSTRAVE

**Tabela (për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive)** Jo x;

2. ***Dokumente të marra:*** Po x;
Nr. Dokumenti i marrë dhe përshkrimi nr. fletëve:

1. *Autorizim përfaqësimi;*
2. *Kopje të Autorizimit të Përgjithshëm, dhënë nga AKEP;*
3. *Një deklaratë për situatën aktuale të veprimtarisë së sipërmarrësit;*
4. *Printime të plotësimeve të detyrimeve për publikimin e tarifave, speed test nga faqja web;*
5. *Kontrata shërbimi me pajtimtarët (internet telefoni dhe tv) si dhe faturë tatimore;*
6. *Informacion dhe dokumentacion mbi masat teknike të nevojshme të marra për të riparuar gjendjen e krijuar të ndërprerjes së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme;*
7. *Informacion mbi rifillimin e ofrimeve te shërbimeve te telefonisë se lëvizshme brenda përcaktimeve te Rregullores Nr.16 datë 16.04.2010 për "Treguesit e Cilësisë se Shërbimit";*
8. *Informacion mbi planet e detajuara të masave që u ndërmorën duke përfshire një analize mbi zonat, pajtimtarët, te cilët u preken nga ndërprerja e shërbimit, si dhe intervalet kohore që pati ndërprerje brenda afateve të dekaluara, në këtë aspekt informacioni të jetë shterues lidhur mbi aksesin e pandërprerë në shërbimet e emergjencës brenda planit të masave, gjatë datës 24/08/2023;*
9. *Informacion mbi masat apo veprimet e ndërmarra lidhur me informimin e përdoruesve të shërbimeve të rrjeteve të komunikimit publik në lidhje me punët e planifikuara për mirëmbajtje ose përditësime, bazuar në afatet e përcaktuara në germën k), nenin 6 të Rregullores nr. 37 datë 29.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për te garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike";*

10. *Informacion mbi planet e detajuara të masave duke përfshire një analize mbi zonat, pajtimtarët e prekur nga ndërprerja e shërbimit të thirrjeve dhe shërbimit data si dhe masat, modalitetet dhe afatet e kompensimit;*
11. *Informacion mbi rastet ku sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a, të analizojë dhe t'i japë zgjidhje shkaqeve teknike dhe mungesës se koordinimit të cilat kanë çuar në shkelje të afateve maksimale të lejuara për portimin e numrit;*

3. ***Vendim për sekuestrim dokumentacioni**:* Jo x;

4. ***Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:*** Po x;

5. ***Detyrimi i sipërmarrësit për paraqitje në zyrën e inspektorit:*** Po x;

*(Nenin 33, pikat 1/b dhe 2, të ligjit nr. 10 433 , datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", si dhe parashikimit të ligjit 9918 i ndryshuar).*
Përfaqësuesi i sipërmarrësit "One Albania" sh.a më datë 27.09.2023 ora 14:00 të paraqitet në adresën: Rruga "Reshit Çollaku", Tiranë për dorëzimin e procesverbalit te inspektimit.

***6. Sende të paraqitura:*** Jo x;

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, *datë 16.06.2011, "Për inspektimin në RSH".*

***7. Gjetjet e konstatuara:***

Ka shkelje të kërkesave ligjore: Po x;
**(N.q.s. Jo, ky procesverbal konsiderohet edhe si vendim përfundimtar)**
*(N.q.s. po të plotësohet si më poshtë);*

**Konstatimet:**

***Përshkrimi i objektit të inspektimit:***

i) *Plotësimi i rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm lënë në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me Nr.04, datë 25.05.2023;*

ii) *Trajtimi i problematikave të evidentuara edhe nga ankesat e pajtimtarëve të ndryshëm në tregun e komunikimeve elektronike që lidhen me procesin e portabilitetit, tarifimit dhe cilësisë së shërbimit kryesisht gjatë muajve Korrik - Gusht të vitit 2023.*

Gjatë inspektimit u konstatua se, Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a, sipas Regjistrit të Sipërmarrësve elektronikë ofron këto shërbime:
**Rrjete publike të komunikimeve elektronike:**



[redacted]

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:
B. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:
C. Shërbime të tjera të komunikimeve elektronike:
D. Shërbime të ofruara sipas standardeve IMT2000/UMTS/LTE:

## 1. Detyrime të mbulimit me rrjet.

Përmes Vendimit nr.14, datë 7.11.2022, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi "Albtelecom sh.a." te sipërmarrësi "One Telecommunications sh.a." Ky vendim konfirmoi mundësinë e bashkimit të dy shoqërive përmes përthithjes së Albtelekom sh.a., nga One Telecommunications sh.a., paraprakisht të autorizuar nga AK tek një sipërmarrës i vetem ONE Albania sha.

Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a ofron shërbimin internet, iptv dhe telefoni në zonën e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Lezhës, Fierit, Korçë etj. Aktualisht, sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a rezulton se ka gjithsej rreth **1 380 000** (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë) abonentë të rrjetit telefonik publik të lëvizshëm (gsm) nga të cilët **1 100 00 (një milion e njëqind mije)** me akses në internet dhe rreth **150 000** (njëqind e pesëdhjetë mije) abonentë në rrjetin telefonik publik të qëndrueshëm (pstn).

## 2. Shërbimet e informacionit

Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a ka kryer regjistrimin për përdoruesit e shërbimin telefonik. Grupi i inspektimit ka administruar kontratë respektive tip një pajtimtari.

## 3. Tarifat

Tarifat e shërbimeve bazë dhe të instalimit aplikohen të unifikuara për të gjithë përdoruesit e shërbimit telefonik dhe janë të publikuara në faqen web të sipërmarrësit të komunikimeve.
Nga verifikimi faktik i bërë nga grupi i inspektimit, sipërmarrësi komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a rezulton se ka ndërtuar faqe web me adresë *https://www.one.al.*





*Foto nga faqe web www.one.al.*

Në faqen web www.one.al, gjenden të publikuara kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë (kushtet e përgjithshme te kontratës), siç detyron neni 98 i Ligjit 9918/2008, specifikisht pikat 1, 2 dhe 5 të këtij neni.



[redacted]

## 4. Sistemet e menaxhimit

Shoqëria "One Albania" sh.a ka vendosur dhe instaluar në muajin Tetor 2022, grupin e sistemeve të reja IT BSS/OSS.

Komponentët (dhe modulet brenda Komponentëve) janë të ndara në një nga kategoritë e mëposhtme - në përputhje me parimin e parë gjithëpërfshirës udhëzues, **Arkitektura e Parë Dixhitale *GP_OV_01***:






*Figura paraqet arkitekturën BSS/OSS në elementët kryesorë*

## 5. Ambientet e sipërmarrësit ku janë të instaluara pajisjet

Grupi i inspektimit i AKEP bëri verifikimin faktik të pajisjeve dhe serverëve në ambientin e sipërmarrësit te dokumentuara me fotot si vijon:





Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" Tiran[illegible] : + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

[redacted]






*Fig. Foto të pajisjeve ne ambientet e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a*

## 6. Historiku i Procesit të cut-overit dhe portabilitetit.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, në bazë të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 "*Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë*", ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi të gjitha dinamikat e ndodhura pranë sipërmarrësit "One Albania" sh.a duke filluar me procesin e cut-overit (kalimin e pajtimtarëve të ish-sipërmarrësit "Albtelecom" sh.a në rrjetin "One Albania" sh.a) dhe deri tek problematikat mbi procesin e portimit të numrave nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a drejt rrjetit të sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a si dhe ankesat e adresuara nga pajtimtarët me objekte të ndryshme.

Gjatë implementimit të procesi procesin teknik të migrimit të numrave celularë nga rrjeti i sipërmarrësit "Albtelecom" sh.a në rrjetin e sipërmarrësit "One Albania" sh.a delikat, u konstatuan problematika, të cilat nuk mundësuar dot transferimin e pjesës më të madhe të pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom drejt rrjetit One Albania si dhe ndërprerje të shërbimeve telefonike në një kohë relativisht 4 (katër) orë. Në kushtet kur ky proces paraqiste problematika dhe ishte kompleks, strukturat inspektuese të AKEP kanë marr masën urgjente **Nr. 533/1 Prot, date 29.03.2023** kundrejt sipërmarrësit "One Albania" sh.a.

Gjithashtu nëpërmjet komunikatës për shtyp dt. 02.03.2023, AKEP në faqen e tij zyrtare në web njoftoi publikun e gjerë mbi procedurat e unifikimit të rrjetit dhe përditësimit të shërbimeve, të "One Albania" sh.a.

Në vijimësi edhe në tentativën e dytë datë 08.04.2023 u mundësua transferimi me sukses i pjesës më të madhe të pajtimtarëve të rrjetit "Albtelecom" sh.a drejt rrjetit "One Albania" sh.a.

***Portabiliteti***

Përgjatë muajve të fundit (Qershor – Korrik 2023) janë raportuara në AKEP problematika të shumta lidhur me zbatimin e procesit të portabilitetit. Krahas strukturave kompetente edhe Grupi Inspektimit ndoqi në vijimësi të gjithë problematikat dhe ankesat e adresuara mbi këtë proces.

***Ndërprerja e shërbimeve dhe incidenti i datës 24.08.2023***

Ndodhur në kushtet e Neni 108 i ligjit 9918/2008, sipërmarrësi One Albania sha ka njoftuar AKEP nëpërmjet e-maileve të datave 24.08.2023, ora 20:19 dhe datës 25.08.2023, ora 10:00, duke plotësuar formularin për raportimin e incidentit të sigurisë dhe/ose cenimit të integritetit si pjesë e raportimit, si dhe duke përshkruar incidentin e ndodhur dhe veprimet e ndërmarra për të eliminuar dhe reduktuar pasojat.

Gjithashtu po në datën 25.08.2023 nëpërmjet shkresës nr. 3954 prot, sipërmarrësi njofton AKEP se shoqëria ka ndeshur një problematike të papritur në sistemet e saj, që kanë shkaktuar ndërprerjen e përkohshme të ofrimit të shërbimit të thirrjeve dhe datave për të gjithë pajtimtarët me një kohëzgjatje:

*data 24.08.2023, ora 05:09 - 07:11 - Mungesë e përkohshme shërbimi voice/data/sms për të gjithë bazën e pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme duke u ndikuar shërbimet voice/data/sms.*

*data 24.08.2023, ora 07:11 - 11:10 - Mungesë e përkohshme vetëm për shërbimin data 4G përafërsisht 590.000 pajtimtarë të telefonisë së lëvizshme.*

Pas zgjidhjes së problemit të sistemit të tarifimit online u ekzekutua procedura e roll-back të trafikut të pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme në këtë sistem në orën 9:10.

Në oren 11:10 është rikthyer shërbimi data 4G për të gjithë pajtimtarët e telefonisë së lëvizshme.

Në komunikimet e grupit të inspektimit me përfaqësues të sipërmarrësit One Albania sha janë kërkuar informacion dhe të dhëna (e-mail dt. 11.09.2023 dhe dt. 20.09.2023) lidhur me:

1. *Masat teknike të nevojshme të marra për të riparuar gjendjen e krijuar të ndërprerjes së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme;*
2. *Rifillimin e ofrimeve te shërbimeve te telefonisë se lëvizshme brenda përcaktimeve te Rregullores Nr.16 datë 16.04.2010 për "Treguesit e Cilësisë se Shërbimit";*
3. *Informacion mbi planet e detajuara të masave që u ndërmorën duke përfshire një analize mbi zonat, pajtimtarët, te cilët u preken nga ndërprerja e shërbimit, si dhe intervalet kohore që pati ndërprerje brenda afateve të dekaluara, në këtë aspekt informacioni të jetë shterues lidhur mbi aksesin e pandërprerë në shërbimet e emergjencës brenda planit të masave, gjatë datës 24/08/2023;*
4. *Masat apo veprimet e ndërmarra lidhur me informimin e përdoruesve të shërbimeve të rrjeteve të komunikimit publik në lidhje me punët e planifikuara për mirëmbajtje ose përditësime, bazuar në afatet e përcaktuara në germën k), nenin 6 të Rregullores nr. 37 datë 29.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për te garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike";*
5. *Informacion mbi planet e detajuara të masave duke përfshire një analize mbi zonat, pajtimtarët e prekur nga ndërprerja e shërbimit të thirrjeve dhe shërbimit data si dhe masat, modalitetet dhe afatet e kompensimit;*



Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" Tira[redacted]: + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax: ++ 355 4 2259 106 info@akep[redacted]

6. *Duke pasur parasysh problemet e vazhdueshme që janë krijuar në sistemin BOSS, një raport nëse ka pasur problematika të sistemit BOSS që prej datës 1 qershor 2023; një raport për hapat teknik të ndërmarrë për zgjidhjen e këtyre problematikave ose përmirësimin e sistemit;*
7. *Duke qenë se shkaku i mungesës së shërbimit në datë 24/08/2023 ishte dështimi i data bazës "InMemory Database" të sistemit BOSS, një raport lidhur me llojin dhe arkitekturën e kësaj të fundit dhe hapat që janë ndërmarrë për të zgjidhjen e problematikës.*

Informacion mbi rastet ku sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a, të analizojë dhe t'i japë zgjidhje shkaqeve teknike dhe mungesës se koordinimit të cilat kanë çuar në shkelje të afateve maksimale të lejuara për portimin e numrit, referencë rastet e mëposhtme;

I. ***Pajtimtari D.H*** *dy numra +35567 482 9922 dhe +35567 482 9923;*
II. ***Pajtimtari X.M*** *me numër+355692601163;*
III. ***Pajtimtari L.L****, dy numrat përkatësisht; +355 69 425 3000 dhe +355 69 425 6000;*
IV. ***Subjektit JON sh.p.k***
*+355676002010, +355676060420, +355684015578, +355684002205, +355684015576, +355682022755, +355684015575, +355686046203*
V. ***Pajtimtari Sh.H, me numër*** *+355696277343;*
VI. *Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje pranë KM, me numrat +682048506, +684081091, +684091377, +686022227, +686062644, +686062653, +689007984, +689088188;*

Për 5 subjektet e mëposhtme me 39 numra ne total,

| Klienti | Totali Nr |
|---|---|
| ADI PROFESSIONAL SHPK | 4 numra |
| D CONTRACT | 3 numra |
| GLOBUS TRAVEL | 17 numra |
| BUNA SH.P.K | 9 numra |
| LF INFISSI | 6 numra |

Gjatë takimit dt. 20.09.2023 në ambientet e sipërmarrësit One Albania nga grupi inspektimit u kërkua të verifikoheshin në kohë reale problematikat e mëposhtme që lidheshin me kufizimin apo ndërprerjen e shërbimeve për pajtimtarët.

1. *S. A numri telefonit 0695386380*
2. *A. T numri telefonit 0683285699*
3. *E. M, numri telefonit 0685909798,*
4. *F. Gj numri telefont 0682120504*
5. *N. B numri telefonit 0686122332*
6. *E. K numri telefonit 0683382998,*
7. *A. P numri telefonit 0672071180*
8. *E. H numri telefonit 0688296072*


Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" në Tel : + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

9. *A. A numri telefonit 0697286656*
10. *F. G numri telefonit 0674069107,*
11. *Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gramsh, (referuar në kontratë me emërtesën Drejtoria e Shërbimit Parësor Gramsh).*

Gjithashtu referuar Raportit të matjeve për rrjetet gsm, umts dhe lte në zonën turistike Theth për operatorin One Albania sh.a u kërkua informacion mbi njoftimin që ky sipërmarrës ka kryer ndaj përdoruesve të shërbimit dhe AKEP-in lidhur me kufizimin/ ndalimin e aksesit në shërbimet e tyre dt. 25.07.2023.

- ✓ Lidhur sa është kërkuar, grupi inspektimit ka administruar dokumentacion e dërguar nga sipërmarrësi One Albania sha (e mail dt. 21.09.2023) ku citohet se:

***1. Sa i takon masave teknike të nevojshme të marra*** *për të riparuar gjendjen e krijuar të ndërprerjes së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme, sqarohet se incidenti i datës 24.8.2023 është shkaktuar nga një problem në Sistemin e Tarifimit Online, ku u konstatua se sistemi nuk po përpunonte trafikun për shkak të përdorimit të lartë të memories (mbi 90%) të bazës së të dhënave në memorie (VoltDB). Mungesa e përpunimit të trafikut për shërbimet voice dhe data, ka shkaktuar ndërprerjen e këtyre shërbimeve për klientët fundorë.* ***Për t'u theksuar është se incidenti ka qenë një ngjarje e izoluar në kohë, ka zgjatur nga ora 05:09 deri në orën 11:10****, kohë ku janë ndikuar shërbimet e ofruara për klientët. Pas zgjidhjes të incidentit, të gjitha shërbimet dhe KPI-të përkatëse janë rekuperuar në vlera normale. Për të siguruar shërbimin për klientët, u iniciua procedura e bypass të tarifimit online si për shërbimet voice ashtu edhe për ato data. Bypass do të thotë që klientët lejohen të përdorin shërbimet voice dhe data pa kontrolluar kreditin e tyre dhe rregullat përkatëse të politikës se tarifimit. Me zbatimin e kësaj mase në intervalin kohor nga ora 06:33 deri në 07:11, shërbimet voice dhe data janë rikuperuar. Pas aplikimit të procedurës së rikthimit për trafikun data, u vu re një ngarkesë e lartë sinjalizimi ne pajisjet Core. Një numër i madh i përpjekjeve të përdoruesve në të njëjtën kohë shkaktoi fluks te larte sinjalizimesh në nyjet Core. Gjatë kësaj kohe, disa nga përdoruesit e 4G nuk mund të lidheshin ose u përballën me vonesa për t'u lidhur në rrjetin LTE. Për shkak të kësaj, nje Emergency Ticket iu drejtua prodhuesit te pajisjeve (Ericsson) për të siguruar stabilitet dhe vazhdimësi të shërbimit. Pas rekomandimeve të prodhuesit te pajisjeve ( Vendors), si një masë paraprake për te ulur sinjalizimin e larte në nyjet Core, u konfigurua një mekanizëm mbrojtës me limit lidhje te përdoruesve 1000 MME në nyjet SGSN/MME, të cilat rregulluan rastet problematike për abonentët 4G. Kjo masë mbrojti nyjet Core nga një bllokim dhe ndërprerje te mundshme, e cila mund ta ndërlikonte situatën, ndërkohë që ngadalësoi dhe zgjati lidhjen e plotë të përdoruesve në rrjetin LTE, e cila zgjati deri në orën 11:10. Pas orës 11:10, situata është kthyer në normalitet dhe të gjitha shërbimet për klientët janë rikthyer ne normalitet.*
*Gjatë kohës së incidentit, nyjet e Sistemit të Tarifimit Online ( Online Charging System)u kthyen në një gjendje funksionale pas veprimeve si më poshtë:*

- *Fshirja e të dhënave në tabelën "TBLT_SESSION_LOOKUP_KEY_MAPPING" dhe restart i aplikacionit DPCC në të tre nyjet.*

*Përveç sa më sipër dhe përveç kësaj, është në shqyrtim aplikimi i një procedure automatike të Bypass/Rollback Charging (vetëm për Shërbimet Data, sepse nuk mund të aplikohet për shërbimet zanore) e cila do të përmirësojë vazhdimësinë e shërbimit për abonentët. Duke aplikuar këtë metodë nuk do të ketë nevojë për ndërhyrje manuale nga inxhinierët PS Core dhe mesazhet e problemeve që vijnë nga sistemi BOSS do të trajtohen në mënyrë automatike.*



[redacted]

- *Kjo u aplikua si zgjidhje e menjëhershme dhe si zgjidhje u vendos të rritet RAM-i në nyjet VoltDB nga 128 GB në 256 GB, i cili u ekzekutua më 26.08.2023, ora 01:30.*


2. ***Rifillimin e ofrimeve te shërbimeve të telefonisë së lëvizshme*** *brenda përcaktimeve te Rregullores Nr.16 datë 16.04.2010 për "Treguesit e Cilësisë se Shërbimit";*

*Kohëzgjatja e incidentit ishte si më poshtë:*

- ***Intervali i pare: 05:09 – 07:11*** *- Padisponueshmëria e shërbimit të plotë për kryerjen e thirrjeve Voice/SMS/Data për të gjithë klientët (përveç thirrjeve drejt Numrave të Urgjencës dhe telefonatave përfunduese celulare)*

- ***Intervali i dyte: 07:11 – 11:10*** *- Padisponueshmëria e shërbimit data 4G për rreth 590* mijë klientë

**Grafiku 1** më poshtë, paraqet statistikat e Call Attempts, Call Setup Failure Rate dhe Call Drop Rate, gjatë dhe pas periudhës së incidentit.



3. ***Informacion mbi planet e detajuara të masave*** *që u ndërmorën duke përfshire një analize mbi zonat, pajtimtarët, te cilët u preken nga ndërprerja e shërbimit, si dhe intervalet kohore që pati ndërprerje brenda afateve të dekaluara, në këtë aspekt informacioni të jetë shterues lidhur mbi aksesin e pandërprerë në shërbimet e emergjencës brenda planit të masave, gjatë datës 24/08/2023;*

*Pasi është kryer Bypass/Rollback i Sistemit te Tarifimit, nyjet Mobile Core u ekspozuan ndaj flukseve te larta te sinjalizimit. Kjo ndodh për shkak të përpjekjeve të pajtimtarëve për të hyrë në shërbim në të njëjtën kohë. Për shkak të sinjalizimit të lartë në të gjitha ndërfaqet gjatë kësaj kohe, nuk është e mundur të dallohen abonentët që nuk kanë arritur të aksesojnë shërbimet e të dhënave ose vendndodhjen e tyre. Gjithashtu, siç paraqitet në grafikët e mësipërm, sjellja e rrjetit dhe e klientëve gjatë periudhës së incidentit është shumë dinamike dhe analiza e ndikimit nga këndvështrimi i rrjetit regjistrohet në bazë të tentativave dhe jo në bazë të MSISDN. Prandaj, konkludojmë se në pjesën fillestare të incidentit janë prekur të gjithë klientët, ndërsa gjatë pjesës së dytë të incidentit, përdorimi i rrjetit 4G nuk ishte i mundur*



[redacted]

*për një numër të përafërt të abonentëve të prekur, i cili ofrohet në bazë të totalit te numrit te përdoruesve 4G minus numrin e përdoruesve 4G që mund të lidhen në rrjet pas procedurës së Bypass/Rollback*

4. ***Masat apo veprimet e ndërmarra lidhur me informimin e përdoruesve të shërbimeve** të rrjeteve të komunikimit publik në lidhje me punët e planifikuara për mirëmbajtje ose përditësime, bazuar në afatet e përcaktuara në germën k), nenin 6 të Rregullores nr. 37 datë 29.10.2015 "Mbi masat teknike dhe organizative për te garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike";*

*Topologjia e pajisjeve Core ( ONE Core Topology) ne rrjetin Mobile ONE ka mbrojtje të plotë nga pikëpamja gjeografike (geo redundancy), e cila siguron disponueshmëri të lartë, duke përfshirë softuerin dhe metodën e aplikuar të licencimit. Në rast të ndonjë problemi në njërën prej nyjeve Core (Laprakë ose Kashari) trafiku kalon në nyjen tjetër automatikisht dhe pa ndikim në trafik. Një praktikë e tillë zbatohet gjatë aktiviteteve të planifikuara dhe/ose të mirëmbajtjes ose aktiviteteve për përmirësimin e nyjeve Core. Trafiku kalon në nyjen mbrojtese ( redundant) përpara fillimit të aktivitetit të planifikuar.*

*E njëjta gjë vlen edhe për pajisjet RAN (BSC dhe RNC) të cilët operojnë me mbrojtje te plote midis nyjeve Lapraka dhe Kashari.*

6. *Duke pasur parasysh problemet e vazhdueshme që janë krijuar në sistemin BOSS, **një raport nëse ka pasur problematika të sistemit BOSS** që prej datës 1 qershor 2023; një raport për hapat teknik të ndërmarrë për zgjidhjen e këtyre problematikave ose përmirësimin e sistemit.*

- ***Incidentet me ndikim në shërbimet e klientit (voice/data/SMS) :***


| ***Domain*** | ***Data*** | ***Kohezgjatja e incidentit*** | ***Pershkrimi i incidentit*** | ***Sherbimet e Prekura*** |
|---|---|---|---|---|
| *IT/BOSS* | *24-Gusht-23* | ***5:09 - 07:11***<br><br>***07:11 - 11:10*** | *Problem me sistemin e tarifimit online për klientët Mobile. Përdorimi i lartë i bazës së të dhënave të sistemit në memorie.* | *Humbja e shërbimeve të zërit/të dhënave/SMS për të gjithë abonentët celularë*<br>*Humbja e shërbimit data 4G për rreth 590,000 klientë celularë* |

7. *Duke qenë se shkaku i mungesës së shërbimit në datë 24/08/2023 ishte dështimi i data bazës "InMemory Database" të sistemit BOSS, lutemi të na **vendosni në dispozicion llojin dhe arkitekturën e kësaj të fundit dhe hapat që** keni ndërmarrë për të zgjidhjen e problematikës*

- **Arkitektura e DPCC dhe ndërfaqet me sistemet.**



Adresa: Rr. "Reshit [redacted] Fax: +355 4 2259 106 info@akep.al





***Problematika lidhur me rastet e kufizimit apo ndërprerjes se shërbimit***

- **Lidhur sa është kërkuar mbi rastet e kufizimit apo ndërprerjes së shërbimeve** për pajtimtarët, konkretisht për numrat e kërkuar informacion është administruar dokumentacioni me email dt. 22.09.2023, pasi ky informacion nuk u bë i mundur të administrohej gjatë takimit në ambientet e subjektit dt. 20.09.2023.

Për **ankuesin S. A me numër telefonit 0695386380** nuk jepet informacion i plote për sa është kërkuar, pra informimi i pajtimtarit mbi ndërprerjen e shërbimit. Në e mail dt. 22.09.2023 informohemi mbi një komunikim të brendshëm të departamenteve të kompanisë One Albania për dërgimin e një sms në 40 000 (dyzet mijë) përdorues me tekst:

- *"One ju rikujton datën për pagesën e faturës suaj pranë dyqaneve të One, për të shmangur bllokimin e shërbimeve tuaja. Nëse ju tashme e keni paguar detyrimin tuaj të rradhës, mos e konsideroni këtë sms. Faleminderit.*



- Gjithashtu në këtë informacion janë bashkëlidhur edhe disa loge të kriptuara të cilat nuk kanë as datë as tekst të deshifruar.

[redacted]



Për sa më lart së pari theksojmë se sms drejtuar abonentëve nuk është korrekte dhe krijon shqetësim në abonenet të cilët nuk kanë detyrimet ndaj sipërmarrësit. *Fjalia e dytë e kësaj sms "Nëse ju tashme e keni paguar detyrimin tuaj të rradhës, mos e konsideroni këtë sms"* nënkupton se sipërmarrësi One Albania nuk ka informacion të qartë mbi abonentët të cilën kanë detyrime të papaguar. Në këtë situatë sipërmarrësi One Albania sha dërgon sms me teks *për pagim detyrimesh* edhe tek ata pajtimtar të cilët mund të shlyejnë detyrimet mujore në afat. Në bazë të ligjit 9918/2008, sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë vetëm tek ata pajtimtar që nuk ka përmbushur detyrime kontraktore (si p.sh. detyrime financiare) një njoftim me shkrim ose në një formë tjetër që është parashikuar dhe pranuar në kontratë nga pajtimtari, duke vendosur afatin kohor prej jo më pak **se 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore**. Në rastin konkret nga informacioni i administruar nuk jepen detaje mbi njoftimit me shkrim ose të një formë tjetër që është parashikuar dhe pranuar në kontratë nga pajtimtari 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore. Loget janë të padeshifrueshme dhe nuk përbëjnë prove mbi plotësimin nga sipërmarrësi të detyrimit ligjor sipas nenit 109 të ligjit 9918/2008.

Gjatë inspektimit në ambientet e sipërmarrësit ONE Albania sh.a, GI, kërkoi verifikim faktit, për te pare përmbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga Neni 109 i ligjit 9918/2008, që ka të beje me lajmërimin e pajtimtarëve 15 dite perpara ndërprerjes së shërbimit.
G.I. kërkoi nga përfaqësimi i sipërmarrësit One Albania sh.a, që të provohej nga ana e tyre, lajmërimi i disa abonentëve specifike, për ndërprerjen e shërbimit sipas Nenit 109 te ligjit 9918/2008. Gjate verifikimit faktik, nga loget e prezantuara nga përfaqësuesi i sipërmarrësit One Albania sh.a, G.I. konstatoi se këto loge, kanë informacione për datën, orën, llojin e sms së dërguar, marrësin e "SMS", informacion nëse "SMS" është dërguar me sukses apo jo etj, **por ne asnjë rast të përmbajtjes se "SMS" që sipërmarrësit One Albania sh.a ka dërguar tek pajtimtarët e kërkuar**.

***Duke u nisur nga ky fakt, nuk provohet që "SMS" i dërguar të pajtimtarët ka qenë specifike për paralajmërim për ndërprerjen e shërbimit apo ndonjë "SMS" tjetër e dërguar nga ana e sipërmarrësit. Gjithashtu, nga log e verifikimit te bere pranë ambienteve te sipërmarrësit One Albania sh.a por edhe nga provat e paraqitura me vone nga sipërmarrësi, rezulton që "SMS" e dërguara janë Broadcast, pra që dërgohen në mase për pajtimtarët dhe jo për secilin pajtimtar.***

Gjatë verifikimit faktik në ambientet e Sipërmarrësit One Albania sh.a, përfaqësimi i sipërmarrësit One Albania sh.a, pranoi qe përmbajtja e "SMS" të dërguar nga sipërmarrësi drejt pajtimtarit nuk ruhet, gjë e cila nuk fakton përmbajtjen e SMS të dërguar drejt pajtimtarëve.



Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" pranë Tel : + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

***Theksojmë që kjo nuk ka te bëjë me ruajtjen e te dhënave sipas nenit 101 te ligjit 9918/2008, por për të provuar që këta pajtimtarë janë lajmëruar siç parashikohet në nenin 109 te ligjit 9918, minimalisht 15 dite përpara ndërprerjes se shërbimit.***

Neni 109 i ligjit 9918/2008, përcakton se: *Sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike mund ta kufizojnë aksesin në shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e pajtimtarit, apo mund të ndërpresin kontratën me pajtimtarin vetëm në rast se pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Sipërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje në kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës. Sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë faturën pajtimtarit me pas pagim. Nëse pajtimtari nuk përmbush detyrimet kontraktore brenda afatit kohor të përcaktuar në faturë, sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë pajtimtarit një njoftim me shkrim ose në një formë tjetër që është parashikuar dhe pranuar në kontratë nga pajtimtari, duke vendosur afatin kohor prej jo më pak* ***se 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore****. Ky njoftim me shkrim duhet të informojë pajtimtarin për kushtet përkatëse kontraktore, në veçanti për kufizimin, ndërprerjen e shërbimit apo ndërprerjen e kontratës dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.* ***Sipërmarrësit nuk duhet të veprojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni para afatit kohor të përcaktuar në njoftimin me shkrim****.*

Në faqen web të sipërmarrësit ONE ALBANIA SHA janë përcaktuar edhe termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme për pajtimtarin.

Në pikën 13 përcaktohet se:

*13.1 Nëse Pajtimtari me pas pagim dhe hibrid nuk përmbush kushtet e përgjithshme të kontratës, ONE Albania ka të drejtë dhe është e detyruar t'i dërgojë një njoftim, me shkrim, brenda një intervali kohor 15 (pesëmbëdhjetë) ditor, duke i njoftuar kohën e arsyeshme brenda së cilës ai duhet të përmbushë detyrimet si dhe duke e paralajmëruar për masat kufizuese që mund të ndërmarrë ONE Albania ne rast mos ndalimi te shkeljeve kontraktore. Pajtimtari detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet e tij për kohën e ndërprerjes së shërbimeve në rrjet.*

*13.3 Në rast se Pajtimtari me pas pagim dhe hibrid nuk kryen pagesën e faturës sipas afatit të saj, ONE Albania ka të drejtë të ndërmarrë sanksione dhe masa kufizuese të ofrimit të shërbimit për Pajtimtarin deri në përfundimin e kontratës, siç paraqitet në vijim:*

*a. One Albania aplikon për çdo ditë vonesë një penalitet në masën 0.5% të faturës mujore të papaguar, deri në pagimin e detyrimit.*

*b. One Albania njofton Pajtimtarin me shkrim ose me SMS/ telefonatë, duke i dhënë kohë 15 ditë për përmbushjen e detyrimit të pagesës dhe/ apo detyrimeve të tjera kontraktore, si edhe e informon pajtimtarin për kufizimin e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse (shërbim i njëanshëm, vetëm hyrës). Pajtimtari ka të drejtë të përdorë Shërbimet e Emergjencës.*



Adresa: Rr. "Reshit Çollaku [redacted] anë Tel : + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

*c. ONE Albania, brenda 15 ditësh nga njoftimi i përmendur më lart, do të ekzekutojë kufizimin e shërbimit të telefonisë, duke ndërprerë ofrimin e shërbimit të thirrjeve dalëse për telefoninë dhe në të njëjtën kohë do të vijohet me njoftimet me SMS/ telefonatë për masat që mund të ndërmerren në vijim.*

*d. Në rast të mos shlyerjes së detyrimeve, me plotësimin/kalimin e 30 ditëve të afatit të pagesës së përcaktuar në faturë, shërbimet e kontraktuara do të ndërpriten tërësisht. Në çdo rast, thirrjet drejt numrave të emergjencës do të lejohen. e. Pavarësisht kufizimeve të parashikuara më lart, Operatori ka të drejtë të gjenerojë faturë për shërbimet e ofruara gjatë muajit të mëparshëm/ vijues sipas planit tarifor të pajtimtarit.*

*f. Gjatë muajit të tretë, ONE Albania gëzon të drejtën të terminojë kontratën duke njoftuar pajtimtarin të paktën 30 ditë përpara.*

**Për ankuesin A.T me numër telefonit 0683285699**, rezulton se ky abonent kishte bërë kërkesë për mbyllje kontrate me dt. 6 shkurt 2023 dhe kalimin e numrit me parapagese. Në data 30 gusht i ndërpritet shërbimi dhe nuk respektohet kërkesa e pajtimtarit për kalim me parapagesë duke vijuar faturimin për më shumë se 5 muaj. Në informacionin e administruar janë bashkëlidhur edhe disa loge të kriptuara të cilat nuk kanë as datë as tekst të deshifruar.




**Për ankuesin E. M, me numër telefonit 0685909798**, në informacionin e administruar pranohet fakti i mbi faturimit dhe bëhet me dije se zbritja 3200 leke me tvsh do te aplikohet në faturën e dates 01.10.2023.

**Për ankuesin F. Gj me numër telefoni 0682120504,** në informacionin e administruar pranohet pretendimi ankuesit që shërbimi është ndërprerë dt. 30.06.2023 por nuk ka të dhëna për sms informuese.

**Për ankuesin N. B me numër telefoni 0686122332 për të cilin** pretendohej se mbyllja e kontratës është kryer me datë 11.04.2023, ndërkohë që faturimi vazhdon për muajit pasardhës (maj, qershor 2023), në informacionin e administruar rezulton se është ndërprerë shërbimi dt. 24 mars 2023 dhe nuk faktohet njoftimit me shkrim ose të një formë tjetër që është parashikuar në ligj dhe aktet rregullatorë.

**Për ankuesin E. K me numr telefonit 0683382998**, pretendohej se është faturuar me shuma të cilat nuk janë në kontratën dypalëshe. Nga informacioni i administruar rezulton se shërbimet e pajtimtarit janë pezulluar në datën 30 Gusht 2023 por nuk faktohet njoftimit me shkrim ose të një formë tjetër që është parashikuar në ligj dhe aktet rregullatorë për pezullimin e shërbimit.

**Për ankuesin E. H me numër telefonit 0688296072**, nga informacioni administruar pranohet fakti se pajtimtari nuk e ka përfituar zbritjen promocionale dhe se do te procedohet me 300 leke zbritje për mos përfitim te Bolt On për muajin Shkurt, Mars, Prill 2023. Ndërkohe rezulton se ka ndërprerje shërbimi dt. 29.07.2023 por nuk provohet teksti i sms së njoftimit për mbyllje shërbimi.



*Tabele me përmbledhjen e informacioneve për rastet referuara.*

**Për ankuesin A. A me numr telefonit 0697286656,** nga informacioni i administruar rezulton se shërbimet e pajtimtarit janë ndaluar në datën 28 Korrik 2023 por nuk faktohet njoftimit me shkrim ose të një formë tjetër që është parashikuar në ligj dhe aktet rregullatorë për ndalimin e shërbimit. Për këtë pajtimtar pranohet fakti se ka bërë kërkesë post-pre dt. 08.04.2023, por data e kërkesës formale 20.06.2023 dhe data e kalimit post2pre 04.08.2023. Pra vetëm pas 4 muajsh nga kërkesa e pajtimtarit është pranuar kërkesa e tij për kalimin e numrit post2pre.

**Për ankuesin F. G email;** gashifatjon02@gmail.com, nga informacioni i administruar rezulton se shërbimet e pajtimtarit janë ndaluar në datën 28 Korrik 2023 por nuk faktohet njoftimit me shkrim ose të një formë tjetër që është parashikuar në ligj dhe aktet rregullatorë për ndalimin e shërbimit.

- ✓ **Lidhur sa është kërkuar mbi** mbi Raportin e matjeve për rrjetet gsm, umts dhe lte në **zonën turistike Theth** për operatorin One Albania sh.a, në AKEP nuk është administruar sipas afateve ligjore informacion mbi kufizimin/ ndalimin e aksesit në shërbimet e pajtimtarëve gjatë dt. 25.07.2023.

Në muajt Korrik 2023 specialistët e Sektorit të Planifikimit dhe Koordinimit te Monitorimit dhe Inspektimit realizuan monitorimin e zonës turistike Theth. për mbulimin e rrjeteve GSM, UMTS dhe LTE. Matjet janë bërë në zgjedhje automatike të teknologjive GSM, UMTS dhe LTE, sipas scriptit në Figurën Nr.1 për shërbimin e të dhënave, si dhe sipas scriptit në Figurën Nr.1 për shërbimin voice. Për monitorimin e cilësisë së shërbimit të teknologjive , u përdor Qëndra e Monitorimit të Cilësisë së Rrjeteve me pajisjet përbërëse. Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë gjendjen reale të operatorit One Albania dhe kushtet që duhen plotësuar në bazë të rregullores për KPI (Key Performance Indicator) për teknologjitë GSM, UMTS dhe LTE, për zonën turistike Theth.

Nga rezultatet e Matjeve të realizuara në drive test-et për shërbimin data të teknologjive GSM, UMTS dhe LTE për zgjedhje automatike, në dedicated mode të realizuara në zonën turistike Theth për Operatorin One Albania.

1. **Për shërbimin data**:

1.1. Mungese totale e ofrimit të shërbimit data.

2. **Shërbimin Voice për teknologjinë GSM// ne zgjedhje automatike**:

2.1. Mungese totale e ofrimit të shërbimit voice.
*(shpejtesi shumë e ulët downloaded për përdorimet e sotme vlerësohet deri në 512kbps) (për teknologjinë niveli i sinjalit i mjaftueshëm por jo i mirë vlerësohet deri në -120 dBm) (për teknologjinë 3G niveli i sinjalit i mjaftueshëm por jo i mirë vlerësohet deri në -108dBm)*

Për sa konstatohet më sipër arrihet në përfundimin se Treguesit e cilësisë së shërbimit (KPI) të operatorit mobile One Albania: në zonën turistike Theth, për shërbimin data në zgjedhje automatike të teknologjisë GSM/UMTS/LTE nuk ishin funksionale për një periudhë prej rreth 3 (tre) orëve që zgjati monitorimi

Në informacionin e administruar dhe dërguar nga subjekti inspektues pranohet fakti se ***Raportimi ne AKEP nuk është kryer pasi impakti është i nivelit shume te ulet, me pak se 1000 abonentë*** (referohu faqes 2 tek raporti informues e-mail 22.09.2023)).

Neni 108 i ligjit 9918/2008, përcakton se: *Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, mund ta kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht aksesin në shërbimet e tyre, pa miratimin paraprak të përdoruesve, nëse kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen apo për probleme teknike në rrjet.*
***Sipërmarrësit duhet të vënë në dijeni AKEP-in dhe përdoruesit*** *për kufizimet apo ndërprerjet e shërbimit, të cilat.*

- ***do të zgjasin më shumë se 30 min.***
-

*Ky njoftim bëhet:*

*a) të paktën 48 orë më parë, në rast te një përmirësimi. modernizimi ose mirëmbajtjeje të planifikuar të rrjetit;*
*b) sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë, pas ndodhjes së kufizimit apo ndërprerjes së shkaktuar*
*c) nga defekte apo dëmtime të rrjetit.*


Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" Tira[illegible]el : + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

**Lidhur sa është kërkuar me rastet e portabilitetit të numrit**, nga informacioni administruar për rastet konkrete rezulton se:

***Adi Professional shpk*** – *Kërkesa për këtë rast është refuzuar për detyrime te pashlyera ne muajin gusht (4 gusht). Në datën 15 gusht është dërguar email nga skuadra e portabilitetit te Vodafone drejt homologeve te operatorit ONE për të kërkuar verifikimin e rastit pasi fatura e korrikut ishte paguar nga klienti. Mandat pagesa per faturen e korrikut është dërguar gjithashtu në këtë email. Nga ONE ka ardhur përgjigje se rasti është dërguar për verifikim. Përgjigjja per këtë rast ka ardhur 15 dite me vone, ne datën 1 shtator, kur ONE ka thëne se subjekti ka detyrime kontraktuale. Rasti eshte ndjekur serish gjate muajit shtator dhe **vetëm ne datën 20 shtator** janë pranuar kërkesat për numrat e këtij subjekti.*

***GLOBUS TRAVEL*** – *Kërkesa për këtë rast është refuzuar fillimisht ne datën 28 gusht 2023. Ne datën 29 gusht, One është përgjigjur se subjekti ka detyrime kontraktuale. Ne datën 15 shtator 2023 ka vijuar komunikimi për këtë rast. Vodafone i ka kërkuar operatorit ONE riverifikim te rastit (dt. 15 shtator) duke i dërguar mandate pagesën qe provonte shlyerjen e faturës se muajit gusht si edhe kopje te kontratës ku thuhej se afati i saj përfundonte ne datën 28/09/2023. ONE është përgjigjur ne datën 20 shtator duke kërkuar te ridërgohet kërkesa për numrat e këtij subjekti. Kërkesat janë pranuar dhe bartja ka përfunduar me sukses ne datën 22 shtator për te gjithe numrat.*

***BUNA SH.P.K*** – *Kërkesa për këtë rast eshte refuzuar ne datën 6 shtator 2023. Është dërguar për verifikim tek ONE fatura dhe mandat pagesa e muajit gusht. One është përgjigjur duke kërkuar ridërgimin e kërkesës e cila është pranuar ne daten 11 shtator.*

***LF INFISSI*** – *Kërkesa për këtë rast eshte refuzuar ne datën 7 shtator 2023. Është dërguar për verifikim tek ONE fatura dhe mandat pagesa e muajit gusht. One eshte pergjigjur duke kerkuar ridergimin e kerkeses e cila eshte pranuar ne daten 11 shtator.*

Për sa më lart, nga informacioni i administruar por edhe nga monitorimi i situatës gjate kësaj periudhe u vu re se kërkesat e dërguara nga Operatori Marres nuk pranohen automatikisht nga Operatori Dhënës ONE pasi dërgohet kërkesa në sistem.

Pra, çdo kërkese për portim për numrat me parapagese refuzohet. Dhe ato kërkesa të pranuara, pranoheshin **vetëm pas një komunikimi të gjatë me skuadrën e portabilitetit** dhe strukturat e AKEP.

Nga analiza paraprake e situatës Grupi Inspektimit konstaton se problematikat e hasuara si për procesin e portabilitetit ashtu edhe për çështjet e rrugëtimit të thirrjeve e kanë zanafillën në pengesat teknike të sistemeve të aplikuara nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a, rezultat i të cilave është edhe rritja e normës së refuzimeve.

Gjithashtu Grupi Inspektimit i AKEP konstatoi se finalizimi i rasteve të referuara problematike merre **një kohë relativisht të gjatë për finalizimin e procesit të portimit**.

Nga analiza e raporteve të gjeneruara nga sistemi CRDB për datat *26 qershor-2 korrik 2023* vihet re se:

- ***Statistika për numrin e kërkesave për bartje të dërguara në CRDB të pranuara dhe/ose të refuzuara për numrat mobile/fiks për çdo operator.***

Vëllimi i numrave të telefonit mbartur në mes të pjesëmarrësve është 30 bartje për numra të telefonise fikse, ndërsa për mobile është 295 numra.

- ***Statistika për numrin e kërkesave për bartje të refuzuara nga operatori dhënës (ODH) për çdo operator marrës (OM).***

Operatori **One Albania (067)** në rolin **Dhënës** rezulton se ka marrë në total 223 kërkesa (numra) për bartje nga operatorët e tjerë, ka pranuar 61 kërkesa dhe ka refuzuar 162.

Në total përqindja e numrave të pranuar për bartje në rrjetin e operatorëve të tjerë është 27.35%.

Operatori **One Albania** (068) në rolin **Marrës**, ka dërguar në total 148 kërkesa (numra) për bartje, nga të cilat i janë pranuar 91 kërkesa dhe i janë refuzuar 57 aplikime. Në total përqindja e numrave të pranuara për bartje në rrjetin e tij është 61.49%.

Në rolin **Dhënës** rezulton se ka marrë në total 243 kërkesa (numra) për bartje nga operatoret e tjere, ka pranuar 102 aplikime dhe ka refuzuar 141 aplikime.
Në total përqindja e numrave të pranuar për bartje në rrjetin e operatoreve të tjerë është 41.98%.

- ***Statistika për kohën mesatare për kthimin e përgjigjeve të kërkesave për portim për çdo operator dhënës (ODH).***

Në lidhje me pranimin e kërkesave për bartje bazuar në: *pikën 6 të nenit 18 të rregullores nr. 43 për mënyrën e zbatimit të "Portabilitetit të numrit"* ku thuhet se:

- *Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se 5 minuta në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve rasteve të muajit kalendarik.*

Më poshtë janë statistikat në përqindje për rastet që respektojnë kufizimet e kohës për çdo operator (*mobil*) dhënës.

| Periudha | ***26 qershor-2 korrik 2023*** | |
|---|---|---|
| *Sipërmarrësit* | *Prepaid* | *Postpaid* |
| One Telecommunications (067) | 97.44% | 86.67% |
| One Telecommunications (068) | 95.30% | 100% |

Nga analiza e raporteve të gjeneruara nga sistemi CRDB për muajin *shtator 2023* vihet re se:


Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" Tiranë + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

- ***Statistika për numrin e kërkesave për bartje të dërguara në CRDB të pranuara dhe/ose të refuzuara për numrat mobile/fiks për çdo operator.***

  Vëllimi i numrave të telefonit mbartur në mes të pjesëmarrësve është 21 bartje për numra të telefonisë fikse, ndërsa për mobile është 1780 numra.

- ***Statistika për numrin e kërkesave për bartje të refuzuara nga operatori dhënës (ODH) për çdo operator marrës (OM).***

1. Operatori **One Albania (067)** në rolin **Dhënës** rezulton se ka marrë në total 1642 kërkesa (numra) për bartje nga operatorët e tjerë, ka pranuar 655 kërkesa dhe ka refuzuar 987. Në total përqindja e numrave të pranuar për bartje në rrjetin e operatorëve të tjerë është 39.89%.

2. Operatori **One Albania** (068) në rolin **Marrës**, ka dërguar në total 722 kërkesa (numra) për bartje, nga të cilat i janë pranuar 416 kërkesa dhe i janë refuzuar 306 aplikime. Në total përqindja e numrave të pranuara për bartje në rrjetin e tij është 57.62%.
   Në rolin **Dhënës** rezulton se ka marrë në total 1732 kërkesa (numra) për bartje nga operatoret e tjerë, ka pranuar 820 aplikime dhe ka refuzuar 912 aplikime.
   Në total përqindja e numrave të pranuar për bartje në rrjetin e operatoreve të tjerë është 47.34%.

3. Operatori **Vodafone Albania** sh.a. në rolin **Marrës**, ka dërguar në total 3376 kërkesa (numra) për bartje, nga të cilat i janë pranuar 1476 aplikime dhe i janë refuzuar 1900 aplikime. Në total përqindja e numrave të pranuar për bartje në rrjetin e e tij është 43.72%.
   Në rolin **Dhënës** rezulton se ka marrë në total 722 kërkesa (numra) për bartje nga operatoret e tjerë, ka pranuar 416 kërkesa (numra) dhe ka refuzuar 306 aplikime.
   Në total përqindja e kërkesave të pranuara për bartje në rrjetin e operatoreve të tjerë është 57.62%.

- ***Statistika për kohën mesatare për kthimin e përgjigjeve të kërkesave për portim për çdo operator dhënës (ODH).***

  Në lidhje me pranimin e kërkesave për bartje bazuar në: *pikën 6 të nenit 18 të rregullores nr. 43 për mënyrën e zbatimit të "Portabilitetit të numrit"* ku thuhet se:

  - Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se 5 minuta në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve rasteve të muajit kalendarik.



[redacted]

Më poshtë janë statistikat në përqindje për rastet që respektojnë kufizimet e kohës për çdo operator (*mobil*) dhënës.

| Periudha | *shtator 2023* | |
|---|---|---|
| *Sipërmarrësit* | *Prepaid* | *Postpaid* |
| One Telecommunications (067) | 99.55% | 98.31% |
| One Telecommunications (068) | 99.39% | 99.44% |
| Vodafone Albania Sh.a. (M) | 99.81% | 100% |

**Në procesin e portabilitetit** evidentojmë faktin se **nuk respektohet parimi "one-stop-shop" i bartjes së numrit**.

Neni 20 i Rregullores Nr. 43/2016 përcakton se "*Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuar në këtë rregullore, por jo më shumë se 8 orë pune për rastet e tjera, duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes.*

Për sa më lart, G.I konstaton se procesi i bartjes/portimit nuk konsiderohet nga sipërmarrësi si një proces i bazuar në parimin "one-stop" ku qytetari/klienti merr shërbimet në një zyrë të vetme dhe pa shpenzuar kohë.

**Shkelja e afateve maksimale te lejuara**

Pika 2 e nenit 20 të Rregullores 43/2016, përcakton se: *Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuar në këtë rregullore, por jo më shumë se 8 orë pune për rastet e tjera, dukë shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes.*

**Bashkëpunimi**

Pika 5 e nenit 18 të rregullores 43/2016 përcakton se: *Në raste të përgjigjes negative, për arsyet e refuzimit apo mosekzekutimit sipas pikave iii, iv dhe v më sipër, Operatori Dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe Operatorin Marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar ne te dhënat.*

Referuar rasteve të dokumentuara, G.I konstaton mungesë bashkëpunimi të Operatorit Dhënës me pajtimtarin si dhe me Operatorin Marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit si dhe zvarritje në kohë të procesit tej çdo afati të arsyeshëm apo edhe të lejuar në rregullore.

Duke analizuar të gjithë këtë tablo të situatës, Grupi Inspektimit të AKEP vlerëson se sipërmarrësi "One Albania" sh.a nuk ekspozohen shkaqet reale teknike, të cilat kanë çuar në problematikën e procesit të portimit.

**Konstatimet përfundimtare**

AKEP kërkon nga sipërmarrësi "One Albania" sh.a një frymë bashkëpunim më të ngushtë me skuadrën e portimit të sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a me qëllim garantimin dhe përdorimin e rregullt të procesit të portabilitetit dhe konkurrencën e ndershme në treg.

Neni 87 i ligjit 9918/2008, përcakton se: *Sipërmarrësit e rrjeteve telefonike publike krijojnë në rrjetet e tyre mundësinë që pajtimtarët të mbartin numrin e tyre të telefonit, pavarësisht nga sipërmarrësi që u ofron shërbimin telefonik. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike fikse janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik fiks.*
*...Mbartja e numrave dhe aktivizimi i tyre* ***bëhen brenda një afati sa më të shkurtër kohor****. Në rastet kur pajtimtari ka lidhur kontratë për mbartjen e numrit te një sipërmarrës i ri, aktivizimi i numrit bëhet brenda një dite pune. Në çdo rast ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë.*

Gjithashtu AKEP tërheq vëmendje strukturës përgjegjëse për marrëdhëniet me rregullatorin, pasi në kuadër të përfaqësimit që ato kanë ndaj çdo strukture tjetër në këtë kompani, duhet të tregojnë përgjegjësi më të madhe në përmbushjen e kërkesave ndaj AKEP, duke dhënë informacione konkrete dhe të detajuara për çdo problematike të konstatuar si legale apo edhe teknike. Konkretisht në takimin e datës 20.09.2023 nuk u arrit të konstatohen dhe dokumentohen rastet faktike të cilat u kërkuan nga grupi inspektimit.

**Sjellim në vëmendje të strukturës përgjegjëse për marrëdhëniet me rregullatorin, se Rregullorja nr.46, date 27.10.2016 "*Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike*", përcakton se:**

> *Subjekti i përcaktuar në autorizimin e inspektimit, me marrjen e njoftimit të inspektimit, është i detyruar ligjërisht dhe merr masat e duhura për t'iu mundësuar inspektorëve realizimin e inspektimit... Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të: - dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar,* ***- ambienteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet, - infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese...***

Bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", inspektoret nuk njoftojnë subjektin paraprakisht në rastet;

a) ***kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;***

*Inspektori ka, gjithashtu, të drejtë të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, dokumentet e ruajtura në trajtë elektronike, regjistrimet elektronike e audio-vizive apo të çdolloj teknologjie tjetër, me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit.*

Në takimin e datës 20.09.2023, grupi inspektimit kishte kërkuar nga përfaqësues të subjektit se duhet të merrte masa që në këtë takim të ishin prezent edhe përfaqësues teknik të sipërmarrësit One Albania, të cilët do të mundësonin verifikimin e ankesave në sistemet elektronike (*ankesa që lidhen kryesisht me portimin apo faturimin e numrave të pajtimtarëve),* e-mail dt. 15.09.2023. Për shkak të efektivitetit të inspektimit numrat dhe emrat e ankuesit/përdoruesit nuk u njoftuan paraprakisht në rrugë elektronike. Gjithsesi në përfundim të këtij takimi nuk u bë e mundur


Adresa: Rr. "Reshit Çollaku" Tiranë + 355 4 2259 571 www.akep.al Fax : ++ 355 4 2259 106 info@akep.al

## IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

*Vendim përfundimtar i veçantë:* po x ;

## V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal inspektimi rastësor u mbajt sot më datën 26.09.2023 në 2 (dy) kopje origjinale, 1 (një) prej të cilave iu dorëzua përfaqësuesit ligjorë të sipërmarrësit të komunikimeve "One Albania" sh.a dhe 1 (një) kopje administrohet nga institucioni i AKEP.

***Inspektori/ët shtetëror dhe personi i autorizuar nga sipërmarrësi datë 26.09.2023;***

Inspektorët shtetërorë të autorizuar për të kryer inspektimin rastësor.

[redacted]

Për sipërmarrësin e komunikimeve elektronike "One Albania" sh.a përfaqësuesi ligjor.

1. [redacted]

*Procesverbali i inspektimit rastësor i njoftohet sipërmarrësit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e përfundimit të inspektimit rastësor.*



[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**SEKRETARIA E KËSHILLIT DREJTUES**

Nr. 2156/1 Prot

Tiranë më 31.10.2023

**PROCESVERBAL**

Lënda: Rend dite Nr.2156 Prot. datë 10.10.2023. Mbledhje e KD-es, datë 12.10.2023

Të pranishëm në mbledhje: [redacted]

**Relatorë:** [redacted]

**Rendi i ditës:**

1. Projektvendim "Për shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit Nr. 2005 prot, datë 29.08.2023, për penalizimin me masë administrative "gjobe" të propozuar ndaj sipërmarresit të inspektuar "One Albania "Sh.a."

2. Projektvendim "Për një ndryshim në VKD nr. 3, datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"".



[redacted]

[redacted]

3. Projektvendim "Për një ndryshim në VKD nr. 4 datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"".

4. Çështje të tjera.

[redacted]

Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Këshillit Drejtues, sipas Njoftimit që keni marrë në datën 10.10.2023. Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, verifikojmë pjesëmarrjen. Marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues [redacted] dhe [redacted] Rendi i ditës, pika e parë për sot ka të bëjë me miratimin e projektvendimit "Për shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit Nr. 2005 prot, datë 29.08.2023, për penalizimin me masë administrative "gjobe" të propozuar ndaj sipërmarresit të inspektuar "One Albania "Sh.a., pika e dyte eshte projektvendim "Për një ndryshim në VKD nr. 3, datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"", dhe pika e tretë është miratimi projektvendimit "Për një ndryshim në VKD nr. 4 datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"", dhe më pasë do te kalojmë në piken e katert e cila eshte çështje të tjera.
Menjëherë po i jap fjalën Grupit të Inspektimit, për të relatuar në lidhje me pikën e parë. Faleminderit!

[redacted]

Përshëndetje! Faleminderit Kryetar! Në radhe të parë do të doja të uroja anëtaret e rinj te Këshillit Drejtues në detyrën e tyre të re . Duke qenë se është mbledhja e pare ju uroj sukese të mëtejshme. Ne lidhje me rekomandimet dhe propozimin e grupit te inspektimit per sipërmarrësin "One Albania" Sh.a , ne zbatim te autorizimit me Nr. 2005 të datës 29.08.2023 grupi i inspektimit ka filluar veprimtarine inspektuese per sipermarresin "One Albania". Përshkrimi i objektit të inspektimit ka qene përkatësisht "Plotësimi i rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm lënë në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me Nr.04, datë 25.05.2023" dhe pika e dytë "Trajtimi i problematikave të evidentuara nga ankesat e pajtimtarëve të ndryshëm kryesisht në periudhën kohore që përkon pas inspektimin e Qershorit". Problematikat që do të trajtoheshin në kontroll lidhen me procesin e portabilitetit të numrit, problematikat në tarifimin e pajtimtarit dhe cilësinë e shërbimit, kryesisht gjatë muajve Korrik - Gusht të vitit 2023. Pas përfundimit të veprimtarisë

[redacted]

[redacted]

inspektuese, grupi i inspektimit konkludoi procesverbalin në përputhje me metodologjinë e inspektimit. Procesverbalin me numër 58, datë 26.09.2023, i është bërë të ditur palës inspektuese, për të cilën kemi marrë dhe vërejtjet e duhura. Në raport janë shpjeguar pikë pas pike dhe qëndrimi i grupit të inspektimit. Ne tërësi Grupi i inspektimit u fokusua në 3 pikat kryesore, që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve ligjore neni 109, duke përfshirë detyrimin ligjor të Sipërmarrësit për të njoftuar Pajtimtarin për ndërprerjen e shërbimit minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para se të ndërpritet shërbimi, duke u bazuar në verifikimin faktik në zyrat e Sipërmarrësit One Albania, pasi u lajmeruan paraprakisht dhe duke marrë në konsideratë tematikën e kontrollit, u konkludua se nuk u verifikua faktikisht përmbushja e këtij detyrimi. SMS-ja e dërguar pajtimtarëve nuk përmbante përmbajtjen e nevojshme, dhe nuk u verifikua kontenti i drejtuar pajtimtarëve dhe afati kohor i përmbushjes sipas ligjit, minimumi 15 ditë para. Sipërmarrësi vuri në dispozicion disa prova (lok file të SMS-ve të dërguara). Problematika kryesore ishte se këto ishin SMS të dërguar në mënyrë masive (bulk ose broadcast), duke i dërguar te 40,000 pajtimtarë. Rastet konkrete, në të cilat grupi i inspektimit bazoi kontrollin, ishin nga këto SMS broadcast të derguar në grup. Asnjë SMS nuk u pa dhe as nuk u paraqit nga provat e sjella nga sipërmarrësi gjatë observacionit të procesverbalit. I vetmi informacion i verifikuar ishte data, ora dhe një sasi informacioni drejtuar pajtimtarëve, gjë që nuk bën të mundur verifikimin e përmbushjes së përcaktimit ligjor të nenit 109. Një problematikë tjetër e konstatuar për këtë pikë ishte se SMS-ja e dërguar në bulk ishte në terma të përgjithshëm me një tekst te detajuar ku thoshte: 'Në qoftë se nuk keni paguar, duhet të paguani, por nëse keni paguar, mos paguani" dhe kjo shkakton një pakënaqësi te pajtimitarët që kanë kryer pagesën, dhe nëpërmjet kësaj SMS-je duhet të shkojnë përsëri në dyqan ose t'i jepnin vëmendje mesazhit të dërguar. Sipërmarrësi "One Albania" nuk arriti të vërtetojë para grupit të inspektimit se ka diferencim dhe informacion të detajuar për çdo SMS dhe për çdo pajtimtar. Pika e dytë me të cilën grupi i inspektimit u njoh dhe kreu kontrollat për disa raste të ardhura në AKEP si ankesa, ku përgjatë muajit Korrik-Gusht janë paraqitur rreth 92 ankesa. Kryesisht këto ankesa lidhen me portabilitetin e numrit, problemet në tarifim dhe mbylljen e shërbimit. Disa raste u morën nga këto ankesa për të bërë verifikimin faktik në zyrat e sipërmarrësit dhe për portabilitetin e numrit u vërejt se ka një zvarritje jashtë afatëve ligjore të procesit. Nuk zbatohet parimi 'one stop shop' për bartjen e numrit, ku pajtimtari të shkojë vetëm një herë në dyqan dhe të finalizojë procesin. u vërejt edhe një mungesë bashkëpunimi midis dy skuadrave të portabilitetit "One Albania" dhe "Vodafone Albania". Pika e portabilitetit të numrit ishte një nga rekomandimet e inspektimeve të muajit Qershor, ku sipërmarrësi ka marrë një dënim administrativ 'Paralajmërim'. Mund të themi se shifrat nga raportet e CRDB në muajin Korrik dhe Gusht tregojnë një përmirësim të situatës pas inspektimit të fundit, por ende ka nevojë për punë dhe vullnet të mirë midis dy operatorëve, që procesi të jetë në përputhje me rregulloren dhe ligjin. Për këtë është lënë një rekomandim dhe dënim administrativ shtesë nga grupi i inspektimit, që të vijohet me përmirësimin e punës. Pika e tretë, ku grupi i inspektimit ka hasur gjatë kontrolleve, ka të bëjë me cilësinë e shërbimit. Në përputhje me rregulloren e cilësisë së shërbimit të AKEP, kryhen matjet periodike bazuar në një plan vjetor, të miratuar nga Kryetari i Këshillit, i cili detajohet në planet mujore. Në muajt Korrik-Gusht, si çdo vit, i jepet një rëndësi të shtuar zonave turistike si bregdetare dhe ato malore. Ne baze të Autorizimit nr. 59/15 prot, datë 04.07.2023 "Për kontrollin dhe kryerjen e matjeve për monitorimin e treguesve të cilësisë", sektori i monitorimit ka kryer matje ne Theth, Raportin e Matjeve konstatohet se Treguesit e cilësisë së shërbimit (KPI) të operatorit mobile"One Albania" në zonën turistike Theth, për shërbimin data të teknologjisë GSM/UMTS/LTE nuk ishin funksionale për një periudhë prej rreth 3 (tre) orëve që zgjati monitorimi në datën 25.07.2023. Për këtë, grupi i inspektimit kryeu të gjitha kontrollin e nevojshëm në adresën e emailit të dedikuar



[redacted]

[redacted]

vetëm për incidentet ose kufizimet e shërbimit, ku operatori duhet të njoftojë AKEP me shkresë zyrtare. Nuk gjetëm asnjë njoftim të kryer nga operatori "One Albania". Sipas rregullores së AKEP, operatori duhet të njoftonte brenda 48 orëve për mungesën e shërbimit, nëse kjo mungesë zgjaste më shumë se 30 minuta. Për këtë arsye, është lënë një rekomandim që operatori t'i japë vëmendje të shtuar këtij procesi dhe që AKEP të njoftohet në përputhje me afatet kohore të ligjit. Në përfundim, duke nisur edhe nga opservacionet dhe komentet e palës inspektuese, grupi i inspektimit ka arritur në konkluzionin se shkelja e parë është më flagrante, pra mbyllja e shërbimit drejt pajtimtarëve pa i njoftuar brenda afatit kohor ligjor 15 ditë. Disa nga rastet, ku ankesat që kemi patur kanë qenë 7 ditë ose dhe 9 ditë për t'u njoftuar. Kanë marrë SMS në fillim të muajit dhe më pas është nderprerë shërbimi më datë 9. Është mjaft e qartë që afati i 15 ditëve nuk është zbatuar. Bazuar dhe referuar germës a), pikës 1, të nenit 135 të ligjit 9918/2008, grupi i inspektimit propozon Këshillit Drejtues të AKEP masën e gjobës sipas nenit 137, pika 1, paragrafi III, nënpika 18, në vlerën 10,000,000 (dhjetë milion) lekë. Referuar masës së denimit administrativ, grupi ka marrë parasysh pozitën në treg të operatorit, që ka patur një denoncim administrativ në inspektimin e fundit me masën paralajmërim dhe gjykon që kjo të jetë masë e gjobës. Në përfundim të aktit të inspektimit, janë lënë disa denime administrative shtesë. Së pari, sipërmarrësi duhet të respektojë detyrimet ligjore lidhur me kontraktorët e furnizimit të shërbimit dhe t'i njoftojë ata para zgjidhjes së kontratës. Sipërmarrësi "One Albania "duhet të respektojë detyrimet ligjore lidhur me publikimin me transparencë, ku kushtet duhet të jenë publikuar në një vend të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre. Sipërmarrësi duhet të respektojë detyrimet ligjore në lidhje me njoftimin e pajtimtarit dhe AKEP për kufizimin ose nderprerjen e shërbimit, sipas pikes 2, neni 108. Sipërmarrësi gjithashtu duhet të analizojë dhe të japë zgjidhje teknike për mungesën e koordinimit në procesin e portabilitetit të numrit, në mënyrë që afatet e përcaktuara në ligj të mos tejkalohen. Gjithashtu është vënë re gjatë vizitës dhe kontrollit faktik që grupi i inspektimit ka bërë pranë zyrave të sipërmarrësit "One Albania ", se ka mungesë të koordinimit në paraqitjen e sistemit. Sistemi BOSS është një sistem i ngritur kohët e fundit dhe ka kaluar fazën e katofit në Prill, ku kemi qenë në ndjekje të ngushtë, dhe inspektimi i muajit Maj ka të bëjë me atë. Përmbledhja e të gjitha moduleve në atë sistem ka krijuar mungesë të koordinimit dhe menaxhimit të mirë të proceseve të sipërpërmendura dhe për ne sistemi ishte shkaku i problematikës. Për këtë, i është lënë përsëri një rekomandim për një dënim administrativ shtesë që sipërmarrësi të rishikojë dhe riparojë problemet teknike të evidentuara në arkitekturën e moduleve të sistemit BOSS me qellim eliminimin e pikave të dështimit si dhe për të përmirësuar sistemin në një afat kohor prej 60 ditësh. Gjatë kësaj periudhe, sipërmarrësit i është rekomanduar të raportojnë në AKEP çdo javë mbi zhvillimin, përmirësimin dhe auditimet e brendshme që ata do të bëjnë për të zgjidhur problematikat e konstatuara. Faleminderit!

[redacted]

Shumë Faleminderit! Nëse ka nga ana e anëtarëve të Këshillit Drejtues komente ose vërejtje në lidhje me relacionin dhe projektvendimin e sjellë nga grupi inspektimit?

[redacted]

I jap fjalen Z. Lorenc Bako.



[redacted]

[redacted]

[redacted]leminderit Kryetar. Faleminderit grupit të inspektimit. Faleminderit Vaso për prezantimin.
Ne të gjithë e kuptojmë se procesi i inspektimit në këtë fazë, i bërë pranë operatorit "ONE Albania", është një proces delikat, sepse pritshmëria është që shkeljet që janë bërë nga operatori do të konvertohen në një masë administrative të tillë. Ne kuptojmë problematikën që ju kemi hasur gjatë procesit të inspektimit. Kjo është njëra anë e situatës, ndërsa ana tjetër është faktike dhe puna që bëjmë së bashku me grupin e inspektimit. Kjo, shoqëruar me problematikat që kanë dalë edhe në media, por edhe me problematikat që kemi hasur në përditshmërinë tonë, tregon se ky nuk është një rast rastësor. Ky proces dokumenton shkeljet që janë evidentuar gjatë kësaj periudhe. Ju përgezoj për relacionin tuaj teknik të saktë në mënyrë që të mos lëni hapësirë për keqinterpretim apo moskuptim nga palët tjera. Faleminderit.

[redacted]leminderit Lorenc. Po i jap fjalën Z. Armer Juka.

[redacted]Bashkohem me kolegun për t'ju përgezuar për punën e mirë dhe përkushtimin që keni treguar gjatë këtyre muajve në lidhje me monitorimin e bashkimit dhe fazës pas bashkimit të dy operatorëve.
Për sa i përket çështjes që lidhet me propozimin për gjobë që ju keni paraqitur, është një çështje që në dukje paraqitet në terma të thjeshtë dhe të qarta nga ana juridike. Ju keni evidentuar shumë mirë detyrimin ligjor dhe rregullator ku sipërmarrësi ka lidhje me nderprerjen e shërbimit, ku njoftimi duhet të jetë me shkrim dhe duhet të bëhet 15 ditë para nderprerjes. E qartë është edhe qëndrimi i sipërmarrësit, i cili ka paraqitur opservacionet e veta, ku në faqen 12 shprehet se sipërmarrësi "One Albania" nuk ka asnjë detyrim ligjor apo rregullator për të ruajtur përmbajtjen e SMS-ve. Platforma nuk e ruan përmbajtjen, pasi SMS-ja shkon te abonentët. Kjo mos-përputhje midis detyrimeve ligjore dhe sjelljes së operatorit është shprehur shumë qartë. Ne do të kemi rastin ta dëgjojmë sipërmarrësin kur ta ftojmë në dëgjese dhe do të kemi më shumë informacion se si ata e shohin këtë çështje, por ju e keni evidentuar në një mënyrë shumë të saktë këtë mos-përputhje midis ligjit dhe sjelljes së operatorit. Unë kam vetëm një pyetje që do të doja një qartësim, në procesverbalin e inspektimit në faqen 13, shpreheni që grupi inspektimit konstatoi se këto loge kanë informacione për datën, orën dhe llojin sms se drguar dhe marrësin. Në lidhje me terminologjin e sms për cfarë nënkuptoni me llojin e sms-së? Cfarë përmbane kjo lloji "sms", cfarë nenkuptoni nga kjo fjale? Përpara se ta mbyll, është e qartë që shkelja që ju keni evidentuar është pjesë e një dështimi ose një mosfunksionimi të sistematik të gjerë që ka prekur sipërmarrësin gjatë muajve të fundit, dhe ju në 25 Maj keni marrë një vendim pas një inspektimi të kryer, ku keni lënë disa rekomandime. Duke pasur parasysh se do të kemi një seancë dëgjimi me sipërmarrësin, do të doja të dija cila ka qene cilesia e raportimit për rekomandimet e lëna nga grupi i inspektimit në Maj, pra raportimet kane qene javore apo mujore? A kanë qëne masat që ata kanë ndërmarr në nivelin e pritshmëris tuaj, dhe cfarë mund të bejnë ata më shumë në vijim, që ne t'ja u vëmë në

[redacted]

[redacted]

dukje, dhe ndoshta pyesim për informacione shtesë kur të jenë prezent në ditet në vijim. Faleminderit.

[redacted]

Faleminderit Armer! Anëtaret e KD-se duhet te shprehin pyetjet e tyre dhe grupi i inspektimit mban shënim, pastaj pergjigjen. Edlira, fjala per ju.

[redacted]

Duke falenderuar grupin e inspektimit, relacioni ishte vërtet i qartë. Nuk kemi nevojë të përsërisim fjalët e njëjta. Ndoshta jane pyetje më shumë shpjeguese ndaj meje. Tek shprehja që tha Armeri, ne do t'i japim të drejtën sipërmarrësit për ta dëgjuar dhe nuk e di, a do të dalim me një vendim sot, apo do të presim të kryejmë dëgjesën? Kjo është më shumë për procedurën. Duke parë se kemi një vendim, pa u përmendur që gjithashtu duhet të shtojmë se në vendimarrje pa ndryshuar konstatimin, pasi të gjithë jemi prekur nga problematikat e "One Albania", por për të bërë më të qartë fjaline ku: 'Nuk duhet: Mos paguani, por duhet: Mos e konsideroni këtë SMS.' Kjo ishte një pyetje për të qenë më të qartë dhe të saktë, pasi më vonë mos të kemi ne gjykatë deshtime dhe kthime për të plotësuar letrat dhe dokumentimin e gjithësisë. Për çdo gjë tjetër, ato janë në relacion, dhe gjithashtu do të doja një shpjegim diku në rreshtat mbi pretendimet e One, A qëndrojnë? Pasi dhe ju i përmendet, diku i keni dhënë shpjegime, por kisha shqetësim mbi këtë pikë, për të tjerat jam dakord me ato që keni evidentuar, pa diskutim që qëndron çdo lloj gjetje. Faleminderit.

[redacted]

Faleminderit Edlira. Po ja jap fjalën Z. Bleron

[redacted]

Shumë faleminderit, kryetar, faleminderit dhe grupit të punës për punën e bërë. Faleminderit edhe për urimin Vaso. Duhet të sqaroj disa gjëra lidhur me dy-tre termat e përdorur në autorizim, procesverbalin e inspektimit, por edhe në PFK. A është ky një inspektim rastesor apo jo? Është shkruar në objektin e përshkrimit 'inspektim rastesor' apo është një inspektim i planifikuar në fillim të vitit? Ndërkohe keni thënë se është bërë për shkak të ngjarjes së 24 Gushtit.

[redacted]

Jo, ky nuk është inspektim rastesor; është vijim i inspektimit. Ky inspektim ka qenë i planifikuar për vitin 2023. Ligji i inspektimit parashikon që inspektimi i programuar mjafton të programohet për vitin dhe mund të kryhet.

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Është cituar në relacion si iniciativë për inspektim rastesor dhe si iniciativë për inspektim, sidomos pas datës së ngjarjes së 24 Gusht që ndodhi ndërprerja e shërbimit. Pra, a nuk është inspektim rastesor

[redacted]

Është cituar gabim 'inspektim rastesor', është i planifikuar.

[redacted]

Një nga konstatimet që është bërë nga grupi i inspektimit është shkelja e nenit 108. Sipas matjes që është bërë më 25 Korrik të këtij viti, ndërsa ju e përfshini këtë në këtë procesverbal inspektimi. Kjo nuk mund të ishte më e saktë që inspektimi të ndiqte rrugën e vetë, pra në datën 25 Korrik grupi i monitorimit sipas rregullores së monitorimit të vazhdonte procedurën për atë gjetje dhe procedurën administrative përkatëse për të. Ky proces i inspektimit, i krijuar një muaj pas asaj date, do të vazhdonte me konstatimet e veta dhe nuk do të merrej me konstatimet e një grupi tjetër inspektimi. Pra, pyetja është: a është me vend të përfshihet në këtë procesverbal inspektimi konstatimi i një grupi tjetër inspektimi që është krijuar një muaj para se të krijohet ky grup inspektimi?

[redacted]

Në date 25 Korrik është kryer procesi i monitorimit, dhe ishte programuar të përfundojë deri më datën 28 Korrik. Pastaj, është kryer procesi i verifikimit, dhe menjëherë pas kthimit janë bërë raportet. Periudha është shumë intensive që të jemi nën kontroll, dhe duke pasur parasysh se sektori i monitorimit dhe cilesisë së shërbimit ka vetëm një specialist, i cili është Albani, duke mbyllur të gjitha seksionet e monitorimit dhe gjenerimin e raporteve do të marrë kohën e vet.

[redacted]

Ideja është që, duke u nisur nga rregullorja e monitorimit, Albani ka gjithë të drejtën të marrë masa në vend.

[redacted]

Kjo nuk është rregullorja e monitorimit por është ajo e cilësisë dhe shërbimit. Kryhen matjet, dhe pastaj verifikohen të dhënat për mos përmbushje të KPI-ve. Kjo merr kohën e vete.

[redacted]

Dakort, ndjesë. Dhe kjo është konstatuar jashtë kohës kur ju jeni ngritur si grup inspektimi një muaj më parë. Pyetja është, a është e vlefshme ta përfshim këtë konstatim në këtë procesverbal? Emaili është i rregullt. Konstatimi i shkeljes është bërë para, pra juridikisht, a ka vlerë ta përfshim si shkelje?



[redacted]

[redacted]

[redacted]

Është data e daljes së raportit. Dua të shtoj se është bërë një konstatim në muajin Korrik, dhe më pas është përgatitur raporti i monitorimit. Gjithmonë si pjesë e procedurës, ngrihet një urdhër tjetër inspektimi për të kryer një inspektim të kësaj procedure monitorimi.

.

[redacted]

Çfarë inspektohet kur konstatimi është bërë? Inspektohet një konstatim i konstatuar? Cila është veprimtaria inspektuese këtu?

[redacted]:

Ne bëjmë vlerësimin e raportit, dhe pa dyshim duhet një inspektor tjetër që të marrë masat e nevojshme.

[redacted]: Pse duhet të bëhet një muaj më mbas?

[redacted]

Sepse procesi i monitorimit vazhdoi në kohën e vet dhe duhet të ngrihet një autorizim inspektimi me inspektor, duke pasur parasysh se inspektimi u shtua për të përfshirë edhe objektin e këtij.

[redacted] A nuk është pune e dyfisht kjo?

[redacted]: Kjo është procedura, Albani nuk mund të vendosi masë administrative, pasi nuk është inspektor. Duhet patjeter një autorizim inspektimi që të marri dhe masën.

[redacted]

Drejtori e ka sqaruar situatën, që inspektimi është kryer sipas rregullores, dhe jemi shumë të qartë. Ideja është që duhet të presim një muaj për një autorizim inspektimi të planifikuar për tu kujdesur për këtë shkelje të konstatuar nga Albani. Kjo është procedura e shkruar në rregullore?

[redacted]

Raporti që ka qarkulluar ka marrë kohën e vetë, dhe erdhi momenti që po ngrihej inspektimi.

[redacted]:

[redacted]

[redacted]

Ju ka ardhur konstatimi i zotit Pashai, janë kryer matjet, ka pasur 3 orë shkëputje dhe nuk ka pasur shërbim. Ju duhet të ngrini grupin e inspektimit për të hetuar dhe vlerësuar nëse është e arsyeshme vendosja e një gjobe?"

[redacted]
Po

[redacted]
Dhe kjo është procedura që ndiqet ne AKEP?

[redacted]
Po

[redacted]
Kjo është e gabuar, sepse konstatimi është kryer dhe Zoti Pashai merr përgjegjësi për atë, dhe ju lehtësisht mund të propozoni gjobën tek kryetari. Kjo është për t'u diskutuar më vonë. Kisha edhe një pyetje tjetër, në fund të ditës do të kemi një proces gjyqësor, ose ndoshta mund të mos shkojmë me vendimin që mund të marrim. Një pyetje që gjyqtari do t'i bëjë vetes për të krijuar bindjen e tij për çështjen në gjykim është, natyrisht, a është provuar fakti dhe e dyta, sa proporcionale janë konstatimet me gjobën ose janë vendosur denimet e tjera administrative kryesore. Thate që janë marrë për baze fakti që subjekti eshte recedivist, është marre për bazë rëndësia dhe pesha që ka në sektor për nenin109. Kush ka qenë racionalja që keni menduar dhe raporti midis gjobës për nenin 109 dhe mos vënia e gjobes për nenin 87. Do të duhet në gjykatë, por dhe përpara Keshillit Drejtues të keni një arsyetim metodologjie për zbatimin e parimit të propocionalittit midis gjobes 10,000,000 lekë pse u vendos për 109, dhe pse nuk është vendosur për 87 qe është shkelje e rëndë, dhe pse është lene pa u gjobitur për nenin 108, thjesht për sqarim.

[redacted]
Doja te bëja një saktësim me afatet kohore. Me raportet jemi njohur në datën 20.09.2023 dhe ja kemi dërguar dhe operatorit. Autorizimi i inspektimit është ngritur në datën 29 Gusht, pra është në periudhën inspektuese. Raporti i zotit Pashai është shpërndarë në datën 20.09.2023.

[redacted]
Pra, grupi i inspektimit është ngritur kur konstatimi është shënuar nga zoti Pashai. Ai ka nxjerr një raport dhe ku mban përgjegjësi, por në date 20.09.2023 ku ju e keni futur direkt në procesverbal.

[redacted]
Në datën 29.08.2023, kemi ngritur autorizimin për inspektim për 30 ditë. Brenda periudhës inspektuese, si drejtori, jemi njohur me raportin në datë 20.09.2023.



[redacted]

[redacted]

[redacted]

Pra, zoti Pashai ka kapur shkelje në daten 25.07.2023?

[redacted]

Jo, në datën 25 Korrik është kryer matja.

[redacted]

Kur zoti Pashai ka qenë i sigurt dhe ka nxjerr raportin e matjeve?

[redacted]

Në datën 20 Shtator është gjeneruar raporti.

[redacted]

Pra kanë kaluar 2 muaj?

[redacted]

Po, ka kohën e vetë.

[redacted] 2 muajsh kujtohet që nuk ka shërbim në Theth. Pra drejtori njoftohet pas 2 muajsh që në Theth nuk ka sherbim.

[redacted]: Eshtë një episod që është kapur gjatë monitorimit, ku monitorohet gjithë Jugu dhe Veriu. Dhe ai do marrë në dispozicion të gjithë kohen e mundur. Gjithë muaji Gusht ezaurohet nga matjet. Nuk punojmë 24 orë në 24, nuk jemi operacionalë 24 orë në 24. Vetëm një person kryen matjet, gjeneron raportet, dhe më pas arrin në konkluzion. Gjatë muajit Gusht, matjet kryhen duke marrë kohën e tyre.

[redacted]

Me falni, fakti është i tille. Flas nga ana inxhinjerike, ku matjet bëhen manuale dhe automatike. Këto matje kanë të dhënat e tyre, të mbledhura nga sistemet e monitorimit. Në momentin e matjeve, nuk shihen problematika. Kur të gjitha të dhënat mblidhen dhe përpunohen në një akt inspektimi, atëherë në qoftë se akti i inspektimit thotë se duam të matim cilësinë e shërbimit nga Maji deri në Gusht, marrim të gjitha të dhënat që janë grumbulluar nga sistemet automatike dhe matjet e kryera manuale që janë kryer aty. Ato shqyrtohen, analizohen dhe vjen në një përfundim.

[redacted]

Shkurtimisht, AKEP vihet në djeni të një shkeljeje të ligjit mbas 2 muajsh? Kjo është përgjigjja?



[redacted]

[redacted]

[redacted]

Shkelja është se atje nuk ka pasur shërbim, dhe si mund të jetë kur nesër pasnesër mund të dalë një akt inspektimi për shërbimin e një operatori tjetër. Merrni një shembull: kryhen matjet në të gjithë Shqipërinë, por askush nuk e di që në Dhermi nga ora 5 am deri në 7 am, Vodafone ose One nuk ka pasur shërbim. Mbasi del inspektori, konstatohet që nuk ka pasur shërbim, dhe këtu është problemi - pse operatori nuk ka lajmëruar.

[redacted]

Duhet të kemi parasysh edhe faktin që jemi një qendër e lëvizshme e monitorimit që monitoron në të gjithë Shqipërinë. Nuk kemi stacione në çdo qytet që të matin cilësinë e shërbimit.

[redacted]

Mundësisht do të doja një përgjigje për pyetjen tjetër. Për raportin e propocionalitet midis mases së dhënë dhe konstatimit. Edhe në raport me shkeljet e tjera të nenit 87 është shkelje shume me e rende se 109. Është ajo e portabilitet, pasi është një nga mekanizmat kryesorë të promovimit të konkurences.

[redacted]

Portabiliteti është një çështje që po merremi prej një viti e gjysmë, dhe po e ndjekim me kujdes. Pas marrjes së denimit administrativ 'paralajmërim' në Qershor, pas problematikave që patën me bashkimin e dy kompanive, me cutover-in dhe ndryshimin e sistemeve të One Albania dhe Albtelecom, ku kaluan në një operator, dhe pas inspektimit tonë pati një rritje të normave të portimit, të cilat i kemi të fakturuara dhe dokumentuara. Pra, nëse normat ishin 20%-30% refuzime, pas Korrik-Gusht, këto janë ulur ndjeshëm. Rekomandimi i lënë në muajin Qershor nga grupi i inspektimit është reflektuar në përmirësimin e punës. Kur themi që duhet të punohet akoma, këto norma duhet të jenë më pak se 10%-20%, dhe procesi nuk duhet të ketë ankesa. Gjithashtu, nuk kemi pasur shumë ankesa. Portabiliteti, në vlerësimin tonë, nisur nga faktet dhe nga ankesat e ardhura në AKEP, normat e refuzimit nuk janë te njëjta me periudhën para inspektimit të kryer. Duhet të marrim parasysh edhe vështirësitë që ka kaluar sipërmarrësi me bashkimin e dy sistemeve. Përseri, i kemi inkurajuar që bashkëpunimi midis skuadrave të portabilitetit të rritet. Kemi bërë takime që ata të jenë në kontakt të përditshëm për problematikat e njerëzve. Neni 87 thotë: Kur nuk zbatohet, që do të thotë mos të ketë një platformë, një sistem që të mundësojë portabilitenin. (Citon Nenin) Për ne, portabiliteti është zbatuar; nëse nuk do të ishte zbatuar, do të kishim propozuar nenin 87, që ata nuk do të kishin një platformë të mirëfilltë për të kryer portabilitetin.

[redacted]

Po për nenin 109? Për gjoben.

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Gjoba prej 10,000,000 lekësh është mëse e faktuar dhe verifikuar nga ne, dhe kemi bindjen e plotë sepse ligji thotë: 'pajtimtarët duhet të njoftohen me shkrim'. Detyrimi ligjor i referuar në vëzhgimet e sipërmarrësit, nuk ka të bëjë me nenin për ruajtjen e të dhënave për 2 vjet, ne nuk e kategorizojmë atë aty. Ne nuk i themi të ruajë përmbajtjen e çdo SMS-je; dhe i themi se për 50 sms-të që i dërgon pajtimtarit, përmbajtjen ku ti i bllokon shërbimin, minimumi 15 ditë, keto duhet ta ruash. Mund ta dërgosh edhe me shkrim këtë njoftim si sipërmarrësi pajtimtarit, sepse ligji e kërkon me shkrim. Pra, ai nuk ka një fakt që e ka njoftuar pajtimtarin 15 ditë para, dhe kjo është flagrante për ne

[redacted]

Në një process eventual gjyqsor, nuk do të thotë gjykata që dhe ju nuk keni fakte, qe sipërmarrësi nuk e ka bërë një gjë të tillë. Në sensin inversa, nuk mund të përdoret edhe nga pala tjetër?

[redacted]

Ne kemi fakte, kemi dhe pajtimtarët. Kemi marrë konfirmime edhe nga pajtimtarët të cilët janë ankuar, asnjë prej tyre nuk e ka sms-në.

[redacted]

Sa ankesa kemi?

[redacted]

Kemi 92 ankesa për këto dy muaj, ku 10 ankesa janë përdorur për tu verifikuar, dhe asnjë prej tyre nuk ka SMS për të verifikuar ndonjë gjë të kundërt ose për të korresponduar me SMS-në e marrë në telefonin e pajtimtarit me datën dhe orën e log-eve që ata kanë sjellë te ne. Kur çdo gjyqtar të shohë një logfile të palexueshëm që mund të përmbajë çfarëdo lloj përmbajtjeje, sipërmarrësi nuk mund të verifikojë përmbushjen e këtij ligji. Kjo nuk ka të bëjë me ruajtjen e të dhënave; ne nuk kemi kërkuar këtë. Ne nuk i kemi thënë të ruajnë përmbajtjen e çdo SMS-je, por detyrimi ligjor është të ruajnë mjetin e fundit të komunikimit që kanë me pajtimtarin, 15 ditë para ndërprerjes së shërbimit.

[redacted]

Nuk e ka detyrim ligjor ta ruaj, kjo është racionale.

[redacted]

Po, e ka detyrim ligjor ta ruaj, e thote ligji, ne nuk patëm asnjë provë, nuk patëm asnjë sms. Ne jemi të hapur edhe për gjykatë.

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Dua të shtoj diçka: përveç SMS-së, e cila nuk është lock dhe nuk mund të verifikohet, e marrin të mirëqenë faktin që kjo SMS është dërguar. Sipërmarrësi ka shkelur dhe nuk ka respektuar afatin e dërgimit të kësaj SMS-je. Të gjitha SMS-të janë dërguar më datën 20 Gusht, dhe ndërprerja e shërbimit ka ndodhur më datën 25 Gusht, pra jo 15 ditë dhe as 5 ditë nuk kanë kaluar nga dita e dërgimit të SMS-së. Kjo është një provë e qartë.

[redacted]

Atëherë, a të përmbahemi kësaj, gjoba prej 10,000,000 lekësh është për mosrespektimin e afatit?

[redacted]

Gjoba, është vënë në përmbushje të nenit 109 në tërësinë e tij. Nga ana teknike, e shpjegoi Vaso.

[redacted]

Është mungesa e 15 ditëshit, dhe ligji është i qartë" Nderprerja dhe kufizimi i shërbimit bëhet, por jo më shumë se për minimumin e 15 ditëve.

[redacted]

Siç e thamë edhe tek portabiliteti, njoftimi bëhet gjithsesi, edhe pse jo në afat.

[redacted]

Kjo është në ligj, nuk është në rregullore.

[redacted]

Edhe portabiliteti në ligj është.

[redacted]

Ligji thotë 'nuk zbatohet portabiliteti', nuk jep detaje.

[redacted]

Gjobën prej 10,000,000 lekësh do ta vendosim vetëm për afatin, pra se nuk është respektuar afati dhe nuk ka patur prova?

[redacted]

Nuk kemi asnjë provë nga sipërmarrësi për këtë komunikim sipas ligjit. Nuk kemi asnjë SMS dhe asnjë letër drejtuar pajtimtarit. Nuk kemi asnjë provë që të vertetojë të kundërtën

[redacted]

E vetmja provë që ne kemi janë 10 ankesat, asnjë gjë tjeter?

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Jo, 10 ankesat janë përdorur si metodikë e inspektimit. Nga 90 ankesat, janë përzgjedhur rastësisht këto 10 ankesa, kështu që as nuk i njohim, as nuk na njohin.

[redacted]

Nga këto 10 ankesa, kanë dalë 8 ankesa problematike, të cilat janë pranuar edhe nga vetë sipërmarrësi. Në një muaj kemi 100 ankesa, dhe 80% prej tyre janë me probleme. Po të marrim këtë lloj proporcioni.

[redacted]

Dhe mendoj që këtu janë vetëm ankesat që kanë ardhur te ne, sepse në qoftë se do i referohemi edhe ankesave të abonentëve të paraqitur në dyqan, edhe ato janë ankesa. Në qoftë se i futemi më thell në rrënjë, janë edhe këto ankesa, që ne nuk i kemi marrë parasysh. Pjesa tjetër është kur ne të dëgjojmë palën tjetër, mund të na dalin edhe këto sqarime dhe mos të bëjmë aludime duke marrë rolet e palës tjetër.

[redacted]

Si parim procedural, të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtën të shprehen ashtu si e gjykojnë. Mendoj se është shumë e vlefshme që nga ana e Bleronit, paraqet mundësinë të vihemi pak në lëkurën e gjykatësit për të kuptuar, sepse në fund të ditës kjo situatë do të shkojë në atë drejtim dhe të jemi relativisht të sigurt për çfarë paraqesim, duke pasur parasysh se gjoba është e lartë, është e pa precedentë për një operator të madh. Është shumë e domosdoshme që në momentin kur e kemi këtë mundësi në KD, le të shprehemi lirishëm, të flasim dhe të sjellim të gjitha pikëpyetjet tona. Ky ishte një diskutim shumë i dobishëm, që paraqet përfshirjen e segmentit të dytë të kësaj procedure që ka të bëjë pikërisht me degjimin, bazuar në ligj, ku duhet të ndjekim me Operatorin që është subjekti i këtij inspektimi. Kjo i referohet Edlires, sigurisht, grupi i inspektimit vjen në KD me një projektvendim, por kjo nuk do të thotë që projektvendimi miratohet sot. Projektvendimi është tashmë paraqitur, dhe do të doja që të merreshin parasysh vërejtjet e Bleronit në lidhje me cilësimin e inspektimit, si dhe të tjera. Është diçka që duhet të reflektohet dhe të mbahet parasysh. Tani, projektvendimi ka ardhur, dhe besoj se mund të korrigjohen gabimet e mundshme materiale para se projektvendimi të vijë për miratim përfundimtar, në një datë të caktuar. Në lidhje me këtë, besoj se ne mund të vendosim një datë për degjesën e subjektit sot, me një mbledhje të posaçme të Këshillit Drejtues. Besoj se në këtë moment, mund të propozohet diçka nga Eriola.

[redacted]

Propozojmë datën 18, ditën e Mërkurë, në orën 10:00. Duke njoftuar sipërmarrësin që sot, i japim kohën e duhur per tu njohur dhe për të sjellë parashtesën e tij përpara Këshillit Drejtues dhe në mënyrë që të marri masat e nevojshme për të qenë prezentë në seancën degjimore, propozojmë datën 18, në orën 10:00. Nëse KD është dakord me datën dhe orarin e propozuar, atëherë sot do të



[redacted]

[redacted]

vazhdojmë me dërgimin e një njoftimi për thirrjen në seancë. Për të sqaruar metodikën e punës së KD, duhet të theksojmë se Keshilli ka një periudhë prej 20 ditësh nga njohja me procesverbalin për të marrë një vendim në lidhje me gjithë procesin.

[redacted]

Pra, që nga dita e sotme, afati eshte më 2 Nëntor. Nëse KD nuk ka ndonjë vërejtje në lidhje me datën e propozuar, e përcaktojmë sot, do të organizojmë një mbledhje në KD në kuadër të dëgjesës së subjektit "One Albania", i cili është subjekti i inspektimit. Në mënyrë që të mund të shprehë mendimet e tij në lidhje me masat e propozuara dhe që t'i japë kohë dhe mundësi Keshillit për të marrë vendimin përfundimtar. Po për sa i përket pyetjeve te Armerit, mund të kemi një përgjigje?

[redacted]

Po kam 2 pyetje, ndoshta i keni parë, ju lutem, duhet ta kishim organizuar që të gjitha pyetjet të jenë të grupuara së bashku dhe pergjigjet të jenë në bllok ose të jepni menjëherë përgjigje pyetjeve të anëtarit të parë që paraqiti pyetjet dhe më pas të vazhdoni me përgjigjet e tjera. Thjesht një vërejtje për në vijim.

[redacted]

Bledi, ju keni qënë në grupin e inspektimit, në këtë cilesi mund të përgjigjeni.

[redacted]

Faleminderit, Kryetar. Për sa i përket pyetjes së parë, që ka të bëjë me çfarë nënkupton lloji i SMS që është gjetur në logon që është vënë në dispozicion nga sipërmarrësi, "lloji i SMS-së" nënkupton që ky SMS ka qenë i transmetuar në masë ose ishte i dërguar për më shumë se një pajtimtar. Në të gjitha log-et që janë në dispozicion nga sipërmarrësi për të trajtuar rastet gjatë inspektimit faktik, rezulton që lloji i SMS-së është "broadcast," që do të thotë se është dërguar te më shumë se një abonent. Në email-et që janë në dispozicion, ku janë komunikimet e tyre të brendshme për të dërguar këto SMS, rezulton që janë dërguar rreth 40,000 abonentëve, duke hedhur poshtë pretendimet se ky SMS mund të ishte për ndërprerjen e shërbimit për një pajtimtar të caktuar. Gjithashtu, përmendet se në logon e disponueshme, ka informacion vetëm mbi datën, orën, llojin e SMS-së, numrin e personit që është dërguar ky SMS dhe nëse është pranuar nga përdoruesi apo jo, si dhe informacione të tjera. Për sa i përket raportimit që kemi kërkuar gjatë inspektimit në muajin Maj-Qershor, që kryesisht ka të bëjë me hapat që duhet të ndërmerren në lidhje me përmirësimin e sistemit të ri, i quajtur "BOSS sipërmarrësi ka raportuar. Mirëpo, duhet të keni parasysh edhe faktin se sistemi "BOSS" është një sistem që përfshin rreth 40 module që komunikojnë me njëri-tjetrin, dhe problematikat e hasura së fundmi janë teknikisht lidhur me faktin që përdor një bazë të dhënash "in-memory," që është përdorur nga një nga modulet dhe kjo ka shkaktuar probleme të hershme. Kanë raportuar se po kryejnë auditime teknike të brendshme në sistemin në tërësi dhe në aspektin e faturimit që ka shkaktuar problemet, dhe po presim një vlerësim përfundimtar të situatës nga ana e sipërmarrësit në fjalë

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Për të plotësuar pjesën e rekomandimeve, kjo ka të bëjë me sugjerimin për përmirësimin e sistemit "Boss" dhe rishikimin e çështjeve problematike, që janë sqaruar dhe sipërmarrësi ka theksuar se po vazhdojnë të investojnë në zgjidhjen e problemeve që kanë ekzistuar deri më tani. Një pikë tjetër është lidhur me portabilitetin e numrit. Nga raportet javore, kemi në dispozicion edhe komunikimet që janë zhvilluar midis dy skuadrave One Albania dhe Vodafone. Përveç kësaj, kemi edhe raportet e shifrave, ku trendi i numrave të aprovuar për portabilitet është në rritje. Kështu që mund të themi se raportet janë cilësore dhe që çështja e portabilitetit është përmirësuar dukshëm nga inspektimi i fundit. Faleminderit.

[redacted]

Një element qe në kundërshtim me muajt e pare të vitit, mbas inspektimit të parë në muajin Maj nuk kemi patur ankesa zyrtare të operatorit Vodafone drejtuar AKEP. Pra kanë filluar duke rënë ankesat e Vodafone për operatorin One Albania. Nuk e di në qoftese jeni ne rregull me përgjigjet, pasi dhe pyetjet u shterën. Po e konsideroje të ezauruar piken e parë të rendit të ditës. Siç u tha, datën 18, ditën e Mërkurë, në orën 10:00 do te zhvillohet seanca e degjesës me grupin e One Albania. Faleminderit grupit të inspektimit.

[redacted]

Mund të vijojmë me pikën 2 të rendit të dites dhe pa u zgjatur shume po ja jap fjalën Z. Jetmir Braha dhe Z. Bledar Kazia për të relatuar për pikën dy dhe tre, besojmë se mund ti përfshijm së bashku.

[redacted]

Faleminderit Z. Kryetar. Kemi paraqitur dy projekt-vendime për disa ndryshime në keto vendime. Për të përmbledhur lidhjen mes tyre, nëse lejoni, do të vijojmë të dy relacionet në një përmbledhje. Kemi pasur zhvillime me transferime të spektrit mes operatorëve Albtelecom, One Albania dhe Vodafone. Vendimet janë marrë si bord në Dhjetor të vitit 2022, por me kërkesë të operatoreve për të pasur një përdorim të qëndrueshëm të spektrit dhe një efikasitet sa më të lartë. Në vendimet e Majit, kemi vendosur që këto pjesë të operatoreve të riorganizohen për të përdorur sa më efikas spektrin. Për përgatitjen e të gjitha atyre tabelave, që ka qenë një punë e madhe për shkak të marrëveshjeve të ndër viteve për çështjet e spektrit, dhe gjatë kohës së punës nga dy drejtoritë, përfshirë edhe marrëveshjet ndërkombëtare kemi vënë re se ka nevojë për saktësime në disa anekse të këtyre vendimeve. Për të qenë më konkret, vendimi Nr. 3 që është marrë për Operatorin One Albania ka nevojë për saktësim në një pjesë të vogël të spektrit 1800 MHz dhe një pjese të spektrit 2100 MHz. Problemi ka dalë gjatë përgatitjes së tabelave, ku një pjesë e transferuar te One Albania është raportuar gabimisht në tabelën e operatorit tjetër. Kjo kërkon saktësim dhe është cituar në projektvendim dhe në relacionin e vendimeve të ndërlidhura, ku këto segmente do të saktesohen në tabelat e njëjta si ato që janë përfshirë në vendimin e KD.

[redacted]

[redacted]

Po kështu, është edhe një problem në lidhje me spektrin 2100MHz për operatorin Vodafone Albania. Vetëm një pjesë prej 5MHz e këtij spektri, e cila është gabimisht lënë tek operatori tjetër, duhet të mbetet vetëm 10 MHz në tabelën e operatorit tjetër. Këto 5 MHz kanë pasur një trajtim të ndryshëm nga operatori tjetër pasi në marrëveshjen e tyre për transferimin e spektrit kishin vendosur që vetëm 5MHz të transferoheshin në vitin 2031. Megjithatë, në marrëveshjen teknike për të garantuar vijueshmërinë e spektrit në këtë brez, ata janë dakordësuar të marrin një pjesë që skadon në vitin 2026. Ndërsa në referencë tek vendimi i Dhjetorit, ky detaj nuk është i përfshirë në shkresën e përbashkët të operatoreve. Kjo kërkon saktësimin e këtyre 5MHz dhe duhet të specifikohet se ata do të jenë në dispozicion në vitin 2026. Këto çështje janë diskutuar me operatorët, ata i kanë shqyrtuar me kujdes dhe teknikisht nuk ka asnjë problem, pasi janë përdorur në mënyrë të përshtatshme siç janë marrë vendimet e mëparshme të AKEP. Megjithatë, për dokumentim duhet të specifikohet ky detaj. Kjo ishte një përmbledhje e detajeve me numra të vendimeve, të shkrimeve dhe datave të paraqitura në raporte. Faleminderit.

[redacted]

Drejtoria juridike a ka dicka per te shtuar?

[redacted]

Akep legjitimohet, sipas ligjit sectorial të administroj frekuancat, gjithashtu dhe saktesimin e tyre.

[redacted]

Në qoftë se kemi diçka tjetër për të shtuar? (Nuk ka diçka për të shtuar)
Nëse Këshilli është dakort, unë propozoj të kalojmë në votim për miratimin e projektvendimit "Për një ndryshim në VKD nr. 3, datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"". Kush është pro?

(Të gjithë shprehen dakort)

[redacted]

Me 5 (pesë) vota pro miratohet.

[redacted]

Atëherë vazhdojmë dhe me pikën 3 dhe nëse Këshilli është dakort, unë propozoj të kalojmë në votim për miratimin e projektvendimit "Për një ndryshim në VKD nr. 4 datë 25.05.2023 "Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh. a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave"". Kush është pro?

[redacted]

[redacted]

(Të gjithë shprehen dakort)

[redacted]

Me 5 (pesë) vota pro miratohet. Shumë faleminderit!

[redacted]

Per ta mbyllur kete mbledhje te KD kemi dhe pikën e fundit, çështje të tjera në qoftëse ka dicka për të komunikuar. (Nuk ka). Po e mbyllim mbledhjen e Këshillit Drejtues. Mbledhja e radhës do të jetë në datën 18 Tetor, diten e Mërkurë, ora 10:00. Shumë Faleminderit!

**Proces verbali u mbajt dhe u zbardh nga** [redacted]
**Proces verbali përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjet) faqe.**
**Proces verbali realizohet në një ekzemplarë.**

[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**SEKRETARIA E KËSHILLIT DREJTUES**

Nr. 2203/1 Prot

Tiranë më 14. 11 .2023

**PROCESVERBAL**

Lënda: Rend dite Nr.2203 Prot. datë 20.10.2023. Mbledhje e KD-es, datë 24.10.2023

**Të pranishëm në mbledhje:** [redacted]

**Relatorë**: Znj. [redacted]

**Rendi i ditës:**

- Projektvendim për "Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit nr. 2005, datë 29.08.2023, për penalizimin me masë administrative me gjobë të propozuar ndaj subjektit të inspektuar "One Albania sh.a".
- Projektvendim për "Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2024 të AKEP"
- Çështje të tjera.

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Këshillit Drejtues, sipas njoftimit që keni marrë në datën 20.10.2023. Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, verifikojmë pjesëmarrjen. Marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues: Z. Bleron Dokle, Znj. Edlira Dvorani, Z. Lorenc Bako, Z. Armer Juka dhe Z. Tomi Frashëri (Kryetar). Rendi i ditës, pika e parë për sot ka të bëjë me miratimin e projektvendimit "Për shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit Nr. 2005 prot, datë 29.08.2023, për penalizimin me masë administrative "gjobe" të propozuar ndaj sipërmarresit të inspektuar "One Albania "Sh.a., pika e dytë është projektvendim mbi "Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2024 të Akep". Menjëhere po vijojmë me pikën e parë, e cila është objekt i një shqyrtimi nga ana e Këshillit Drejtues, nisur javen e kaluar, kryesisht me paraqitjen në Këshillin Drejtues nga ana e grupit të inspektimit të masës së gjobës së propozuar. Në vijim të inspektimit të kryer dhe në fund kur ka mbaruar inspektimi është ndjekur më pasë nga dëgjesa. Sipas procedurës me sipërmarrësin "One Albania" Sh.a, gjatë së cilës sipërmarrësi ka paraqitur vërejtjet dhe gjithatu argumentet e tyre, mbështetje të kërkesës për ri-shikim të masës së gjobës. Kjo është mbledhja e vendimarrjes nga ana e KD, në lidhje me gjobën e propozuar nga grupi i inspektitmit, ku është relatuar disa herë mbi këtë çështje, dhe përsëris që gjatë dëgjesës së dedikuar edhe sipërmarrësi ka paraqitur verbalisht por më pas ka trasmetuar edhe me shkrim argumentet e tij. Besojë se nëse ka nga ana e anetareve te Këshillit Drejtues, dicka për të shtuar, vërejtje, komente apo pyetje të tjera, besoje se mund ta konsiderojmë të kryer informimin e plotë të Keshillit mbi këtë çështje dhe besojë në aftësinë e Këshillit për të marrë një vendim. Përpara çdo gjëje i jap fjalën anëtarëve të Këshillit nëse kanë dicka për të thënë apo për të shtuar meqenëse është seanca e vendimarrjes në këtë pikë. Po Bleron.

[redacted]

Unë thjesht do të doja të ndaja dy meraqe që kam në raport me VKD, e cila u la sot për tu riparë dhe për tu ritrajtuar dhe pas seancës dëgjimore që kryem me sipërmarrësin dhe grupin e inspektimit. Gjithmonë lidhur me merakun që e kam bërë present edhe në seancën e parë që kemi zhvilluar në raport me shqyrtimin gjyqësor. Në fakt hapsirat që lë neni 109 i ligjit, përsa i përketë njoftimit me shkrim ose sipas një formati të parashikuar dhe të dakortësuar me pajtimtarin në kontratë, që në fakt mund ta bëjë pak të ndjeshme mbrojtjen tonë në gjykatë. Gjithashtu dhe mungesa e asaj që unë do të doja ta shikoja më të qartë në VKD të një sqarimi lidhur me racionalen ose arsyetimin që grupi inspektimit ka kryer mbas pikes 1.1 tenenit 137, sesi ka arritur në konkluzionin e masës së gjobës për sa i përketë respektimve të parimit të propocionalitetit që do të thotë, që në VKD duhet të ishte arsyetuar sipas pikës 1.1 të 137. Eventualisht të ishin konsumuar tek rëndësia dhe kohëzgjatja e kundravajtjes, rrethanat e kryerjes së kësaj kundravajtje, nëse kundravajtësi rezulton i denuar administrativisht edhe më parë dhe pasojat që kanë ardhur nga veprimi dhe mos veprimi. Këto janë kriteret të cilat ligji parashikon që inspektimi ti ketë parasysh në momentet e propozimit të gjobës dhe në momentin e [redacted] dosjes së

[redacted]

[redacted]

gjobës. Kjo është e ndarë sipas nenit 185 në dy momente. Kjo mungon në VKD dhe gjykoj se është e nevojshme, se do të jetë një nga pikat e shqyrtimit gjyqësor më vonë dhe duhet të jetë një pikë mbrojtjeje që AKEP duhet ta ketë për të mos ç'vlerësuar të gjithë procedurën hetimore dhe atë inspektuese. Kjo i shërben gjithë punës, komplekse dhe të vështire, që ka bërë grupi i inspektimit. Në një lloje tërheqje dhe të pretendimeve të sipermarrësit përsa i përketë pretendimit të tyre në mos zbatimin e propocionalitetit dhe gjithashtu do të kisha dashur në VKD një shterim i nenit 109, përsa i përketë mënyrës për njoftimin dhe shkeljeve kontraktuale që në fakt për mendimin tim lë një hapësirë goxha të konsiderueshme kur thotë, njoftim me shkrim ose sipas një formati të parashikuar në kontratë, mund ta bëjë të ndjeshme praktikën apo vullnetin tonë dhe në shqyrtimin gjyqësor. Jam ende i paqartë përsa i përketë momentit procedurial që pason me vendimin. Pra në vendimin përfundimtar të konsiderohet VKD-ja apo vendimi përfundimtar që do të nxjerri inspektimi, si do procedohet më tutje, do të kemi përseri shqyrtim administrativë apo do të presim dhe të vijojmë me arsyetimin ligjor. Faleminderit.

[redacted]

Faleminderit, dëshiron dikush tjetër? Po Armer.

[redacted]

Kjo është më shumë një pikëpamje e imja mbi çfarë kemi parë dhe në dosje. Nga grupi i inspektimit dhe nga parashtresat që morëm kur dëgjuam sipërparrësin. Strukturuar në bazë së siles, ne duhet ta shqyrtojmë çështjen. Duhet ta shikojme ne në tre momente, a kemi shkelje, a kemi shkelje sistematike dhe momenti tretë nëse kjo shkelje është e një nature të rëndë që e meriton gjobën, apo meriton një masë më të lehte. Ne jemi përpara një shkeljeje, në sytë e mi nuk ka dyshime dhe qartësisht e pranoi edhe vetë sipërmarrësi. Ashtu siç e tha edhe Bleroni, neni 109 dhe nga vetë parashtrimet e sipërmarrësit u tregua qartësisht qe ata kane zgjedhur formatin me shkrim. Per mendimin tim formati me shkrim, mbetet aty dhe nuk mund të zhduket. Kjo barrë prove bie mbi sipërmarrësin. Këtu ka shkelje dhe është e qartë. Shkelja e detyrimit të afatit minimumi 15 dite, para ndërprerjes së shërbimit, kjo është e provuar, sepse në pyetjen që ju be përfaqësuesit të sipërmarrësit ishte: A ka një mesazh tjetër përvec atij që ne lexuam dhe ai tha jo. ne jemi duke punuar dhe duke rishikuar, pasi mesazhi nuk kishte asnjë afat se kur duhej të bëhej pagesa nga ana e pajtimtarit. Shkelja është e provuar. Pyetja e dytë, në rast se kjo shkelje ka natyrë sistematike, pra asgjeson qëllimin e ligjëvënësit, ku ligjëvënësi e ka vendosur atë dispozitë aty, dhe ka vendosur një gjobë të rëndë me një synim të caktuar. Një pyetje tjetër kishte të bënte me një rast ku pajtimtari pretendonte shkelje, dhe paraqitet pranë dyqanit ose ne zyrat e kujdesit të klientit dhe pyet në lidhje me këtë gjë, mua nuk më është përmbushur kontrata dhe nuk ka marrë përgjigje nga sipërmarrësi. Pra, sipermarrësi nuk ka një element ku ta provojë ka përmbushur këtë pikë. Sipërmarrësi nuk e pranon që është sistematike, une mendojë që është sistematike. Pika e tretë, a është e rende? Apo e përsëritur? Dhe a e mertion këtë gjobë apo një masë më të lehtë. Ne favor të paralajmërimit qëndron fakti që nuk ka një masë pikërisht për këtë shkelje. Cështja kryesore është nëse kjo shkelje është aksidentale, sporadike dhe e shkëputur nga

[redacted]

[redacted]

sjellja e përgjithshme e sipërmarrësit, apo jemi përpara një rasti tipik që tregon një disfunksionim, ndoshta jo me dashje prej tyre. Ky mosfunksionim i vazhdueshem që ka për efekt nëperkëmjen, e te drejta jemi përpara së dytës apo jemi përpara një shkeljeje aksidentale që do meritonte klemencën e KD. Do të doja dhe dy komente për pikat që ngriti Bleroni, për çështjen e zbardhjes së vendimit të (VKD) është në dorën tonë që ta zbardhim dhe të kemi një draft dhe një vendim Këshilli Drejtues me një cilësi sa më të mirë. Mendojë se Drejtoria Juridike duhet të jetë e përfshirë në këtë proces. Ndërsa i përkete pikës tjetër, se kush është vendimi përfundimtarë, është vendimi i Këshillit dhe nuk mund të dalë një sturkture që është në varësi të Këshillit të jetë pas fjalës tonë. Kjo është pikëpamja ime. Në qoftëse operatori do vije me një ankim tek ne, duhet të kemi një vendim unifikues, duhet të jetë dhe praktikë për të ardhmen. Faleminderit.

[redacted]

Faleminderit, po Edlira.

[redacted]

Duke u bashkuar, dhe duke mos dalë para arsyetimit ligjor të dy anëtarëve të Këshillit, unë nuk e presupozova që Bleroni po diskutonte ato tre pika që Armeri i parashtrojë, ku u la si detyrë të plotësoheshin të gjitha dosjet, edhe me kërkesat e ONE Albania në VKD. Të gjitha arsyet që e kanë çuar KD në këtë lloj vendimarrje, se jemi përpara një keq përdorimi i të drejtave të konsumatorëve, në qoftëse unë përdor termin e duhur. Ky nuk është një rast i vecantë, pasi ne për rastet e veçanta, kemi qenë tolerante. Ne jemi përpara një veprimi të ndodhur, për pjesën që duhet ta plotësojnë dhe të jemi të qartë. Përderisa ne marrim vendimin për gjobe duhet dhe të jemi të saktë kur të vijë koha në qoftëse operatori do ta ankimojë. Faleminderit,

[redacted]

Duke parë edhe termat e përgjithshme të kushteve të kontratës që janë miratuar nga AKEP përpara së të publikohen, pika 13, njoftimi eshtë vendosur me sms dhe telefonatë dhe jo me shkrim, pra janë termat e përgjithshme të vendosura edhe në procesverbalin e inspektimit. Kërkesa ime të kemi më shumë kujdes në VKD, pra në dy shtyllat ku janë, e para One Albania nuk ka prova ku të vërtetojë dhe së dyti që është parë sipas një metodologjie, pra në VKD dhe të gjejë hapsirë ky shterim.

[redacted]

Për të shtuar edhe unë dicka me të gjitha këto, jam shumë dakort. Bleroni tha që në VKD duhet te përfshihen parashtrimet e palës tjetër dhe ti përgjigjet deri diku pikë për pikë, sigurisht do fokusohet tek çështja e masës së gjobës dhe shkeljes së masës, duke përjashtuar pikat e tjera sepse në dëgjesë oponenca që u bë nga ana e sipërmarrësit përfshinte edhe pika të tjera por nuk mund të jenë në shqyrtim. Ne kemi kompetencë në këtë rast specific, duke u marrë me masën e gjobës dhe sigurisht edhe me masën që ka çuar në marrjen e kësaj gjobe. Në vendimin e Këshillit Drejtues, cfarë është parashtruar praktikisht nga sipërmarrësi duhet të renditet, duke përjashtuar

[redacted]

[redacted]

rast pas rasti pikat të cilat nuk janë pjesë në vendimarrje dhe duke u fokusur në këto vendimarrje. Ne e kemi parasysh, por duhet thjeshtë të them që jemi deri diku të shtrënguar nga disa afate dhe duhet të shprehemi dhe pa diskutim që zbardhja duhet të përfshije të gjithë elementët. Kjo është hera e parë dhe nuk ka precedentë të mirëfilltë mbi dënimin, me një masë gjobë për një sipërmarrës të madh në fushën e telefonisë, me shumë problematika, dhe mund ta themi në Këshill se ndoshta mungon edhe një lloj aftësie për të hartuar vendime që janë shumë komplekse, sepse është vendim kompleks. Unë edhe nëse anëtaret e tjerë te Këshillit janë dakort me idenë që dhe Drejtoria Juridike të ndihmonte në hartimin e mirë të vendimit, pasi ky do jetë vendimi i KD-se dhe këshilltari juridik i Këshillit është Drejtoria Juridike. Në qoftëse anëtarët kanë kundërshtime mbi këtë pike, patjetër duhet ta shprehin këtu. Ne do japim ndihmesën, pasi jemi autorët e këtij vendimi, do japim ndihmesë në zbardhjen e mirë, në draft-imin e mirë të vendimit, menjëherë, pasi në parim të kemi rënë dakort mbi vendimin që do marrim këtu. Vendimi i cili do terminojë edhe hartimin e një vendimi të saktë, i cili detyrimisht do të jetë shumë më i shtjelluar dhe shumë më konform standarteve të cilat u përmendën këtu, me shumë të drejtë nga Bleroni sesa drafti i cili ka ardhur tani. Mbi këtë që thashë, dhe në lidhje me pikat e tjera që Bleroni i pati ngritur edhe më parë dhe janë të drejta në lidhje me garantimin e një lloj 'suksesi' në gjykatë .Të gjitha këto do merren parasysh, pjesës tjetër nuk dua ti hyjë në themel, që u referua dhe nga Armeri, janë pohimet e sipërmarrësit, ku ishin të qarta ndonjëherë edhe pa dashje në lidhje me faktin se cenet e mesazheve të dërguara ishin dhe janë të tilla, sa dhe vetë sipërmarrësi ngutet të ndryshojë përmbajtjen e tekstit dhe është totalisht i pamundur të jape qoftë edhe një indicie, përmes cfarë do lloj mjeti elektronik të mundshëm, ku mesazhi i duhur është nisur në afatet e duhura, në personin e duhur, dhe  në afatet e kontratës. E fundit që do të them është çështja e nenit 109 dhe ajo e mesazheve, që dergohen për të njoftuar mbi afatet e caktuara për shlyerjen e pagesës, lidhen ngushtësisht me cilësinë e shërbimit ndajë pajtimtarit dhe me një element që ka të beje me cilesine që është faturimi. Nga ankesat qe na vijne, janë tërësisht një problem teknik që po kthehet në një problem akut për pajtimtarin, keq faturimet, mbi tarifimet e të tjera. Njoftimet që shkojnë drejt pajtimtrit krijojnë një konfuzion jashtëzakonisht të madh, dhe një fustrim tek pajtimtari, dhe në vijimësi me një mos funksionim nga sipërmarrësi dhe nj vijimësi nëpërkëmbje të të Drejtave të Konsumatorit. Në lidhje me atë që përmendi Bleroni dhe Armeri dhe une mendoj që praktikisht në rast se ka një ankim ndaj këtij vendimi nga ana e sipërmarrësit ne do na duhet një vendim unifikues dhe do i përgjigjemi kërkesës në qoftëse vjen, vendosour në mënyrën përfundimtare dhe për tu shkarkuar nga një ripërsëritje e pa kuptimtë edhe nga ana proceduriale dhe ajo supstanciale edhe për ta adresuar sipërmarrësin drejt gjykates. Kjo është hipotetike, vetëm në rast se do të shrohet, besoj se dhe ky është vendimi i Këshillit. Në rastin se do shtrohet kjo hipoteze, ne do ta konkretizojmë në këtë frymë. Kjo ishte ajo qe doja të shtoja.

[redacted]

Në qoftë se kemi diçka tjetër për të shtuar? (Nuk ka diçka për të shtuar)
Nëse Këshilli është dakort, unë propozoj të kalojmë në votim për miratimin e projektvendimit për "Shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit nr. 2005, datë 29.08.2023, për penalizimin me masë administrative me gjobë të propozuar ndaj subjektit të inspektuar "One Albania sh.a".

Kush është pro?

(Të gjithë shprehen dakort)

[redacted]

[redacted]

[redacted]

Me 5 (pesë) vota pro miratohet. Faleminderit ,

[redacted]

Ju lutem në qoftëse mund të thërrisni Znj. Etleva Alushi, për të relatuar për pikën e dytë të rendit të ditës. Atëherë vijojmë me pikën e dytë të rendit të dites që ka të bëjë me miratimin e projektvendimit për "Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2024 të AKEP". Ne jemi njohur me relacionin e mëparshëm në lidhje me buxhetin e vitit 2024, jemi njohur edhe me modifikimet, janë paraqitur dhe në relacionin me shkrim, do të doja në qotëse dhe Këshilli është dokort, të përqëndrohem vetëm te modifikimet, tek relacioni dhe VKD e ri-pare, duke u bazuar tek mbledhja e fundit. Faleminderit dhe fjala për ju Znj. Alushi.

[redacted]

Faleminderit Z. Kryetar dhe të nderuar anëtare. Drejtoria e Finances reflektoi pritshmërine e realizimit të të ardhurave nga pagesat për AKEP, per vitin 2024 duke reduktuar pritshmërine që kishim vënë në caktim të përdorimit të frekuencave, dhe pasi u pa fondi i shpenzimeve, u vendos se për vitin 2024, Buxheti do të jetë 393,000,000 lekë. Ky zë i të ardhurave nga pagesat, i reflektuar në shpezime do të ketë reduktime në dy nga zërat kryesore, në Paga dhe Shtesa si dhe në Shërbime. Në paga dhe shtesa rrezulton në një diferencë prej 15,000,0000 lekë. Kjo përbëhet nga 13,000,000 lekë nga pagat, si dhe 1.800,000 lekë nga Sigurimet Shoqërore dhe 7,200,000 nga Shërbimet. Në zërin e Shërbimeve reduktimet janë në shpenzime për djeta jashtë vendit dhe 1,800,000 lekë janë nga zëri i shërbimeve për ruajtjen e objektit dhe kemi reflektuar kontratën e re, të cilen e lidhëm tani me subjektin. Kemi dhe 1,800,000 lekë nga shpenzimet për qeratë, të gjitha së bashku bëjnë shumën e 22,000,000 lekësh, që është zbritur nga planifikimi fillestar që kishim bëre duke marre parasysh këto gjëra. Faleminderit,

[redacted]

Për arsye të ndryshimeve të ndodhura dhe që kanë qenë të pavarura nga institucioni, na kanë sjellë në këtë situatë, por gjithësesi kanë plotësuar nevojat e stafit dhe për këtë mund të jemi vetëm të lumtur dhe të kënaqur. Unë falenderojë Drejtorinë Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për rishikimin e shpejtë të projektbuxhetit të propozuar dhe jam më i qetë tani për mundesinë e realizimit, e rëndësishme është që institucioni mos të ketë probleme me mosrealizimin e buxhetit dhe të bazohet në të ardhura konkrete të realizueshme dhe jo thjeshtë në disa hipoteza të dëshirueshme, të cilat në rastin se konkretizohen përseri nuk do të kenë impakt në buxhetin e këtij viti dhe po të jenë ,do të jenë një plus, duke lejuar AKEP të mundesojë disa shpenzime dhe disa shpërblime apo shtesa në pagë, shpresojë të ndodhë, por ishte e pa mundur të merrej si bazë duke patur parasysh edhe shuma që përfaqësonte. Jemi në disa norma që dhe për Ministrine e Financave dhe për Këshillin e Ministrave nuk do ngjallim pikëpyetje në miratimin e buxhetit tonë. Duke ju falenderuar për punën dhe gjithshtu anëtaret që janë përfshirë për të dhënë ndihmesën e tyre. Për gjithë ndihmën dhe përkushtimin, ju jam mirënjohës dhe meqenëse nuk kemi komente mbi relacionin dhe mbi draft VKD po propozoje dhe nëse Këshilli është dakort,

[redacted]

[redacted]

unë propozoj të kalojmë në votim për miratimin e projektvendimit për "Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2024 të AKEP"

Kush është pro?

(Të gjithë shprehen dakort)

[redacted]

Me 5 (pesë) vota pro miratohet. Faleminderit ,

[redacted]

Tek çështje të tjera nuk kemi dicka për të diskutuar, përveç faktit që Marrëveshja e Mirëkuptimit do të nënshkruhet në Kosovë (Prishtinë) në datën 07 Nëntor. Eshtë Marrëveshja me ARKEP. Kjo do të kryej në Mal e Zi, por për arsye të politikave rajonale nuk u krye. Do të ketë një nënshkrim bashkëpunimi dhe më pas do të jetë nënshkrimi i disa marrëveshjeje me disa nga vendet e tjera të Ballkanit Perendimor. Nuk do të përfshihet vetëm Serbia, pra do jenë Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky ishte informacioni që kisha për të ndarë me KD.

[redacted]

E mbyllim mbledhjen e Këshillit Drejtues. Do të merrni njoftim për mbledhjen e rradhës shumë shpejt. Faleminderit.

**Procesverbali u mbajt dhe u zbardh ng[redacted]**
**Proces verbali përbëhet nga 7(shtatë) faqe.**
**Procesverbali realizohet në një ekzemplarë.**

[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 1695 Prot. Tiranë, më 15.6.2023

# V E N D I M

**Nr. 5, datë 15.6.2023**

**PËR**

**"PËRDORIMIN E KOMISONIT TË PËRFITUAR SI AGJENT TATIMOR, NGA AKEP, NË FORMËN E SHPËRBLIMIT PËR VËSHTIRËSI NË PUNË, PËR VITIN 2023"**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

| | |
|---|---|
| 1. Z. Tomi Frashëri | Kryetar |
| 2. Znj. Edlira Dvorani | Anëtar |
| 4. Z. Lorenc Bako | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 15/06/ 2023, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për "*Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare*", miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Mbi përdorimin e komisionit të përfituar si agjent tatimor, nga AKEP, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2023;**

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 3, e nenit 117, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, *"Për komunikimet elektronike në RSH"* ***(ligji9918/2008);***
2. Pika 4, e nenit 2, pika 3 e nenit 8, si dhe gërma e), e nenit 11, të Ligjit Nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar. ***(ligji nr. 9975/2008)***;

3. Pika 1.b) e nenit 5 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" ***(ligji nr. 9920/2008)***;

4. Pika 1 e nenit 8 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar ***(ligji 10296/2010);***

5. VKM Nr. 750, datë 01.12.2022, "Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023";

6. Pika 3 dhe pika 6 e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe AKEP, Nr. 30, datë 23.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit", i ndryshuar;

7. Seksioni 1 i Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat kombëtare", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 27 datë 16.12.2014;

8. VKD nr.12 datë 14.09.2022, "Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe Projekt Buxhetin e vitit 2023 të AKEP";

9. VKD nr. 93, datë 10.12.2018, "Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare"

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit të përgatitur nga DJI dhe DBMF (***Relacioni***);
2. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar, si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. AKEP, bazuar në legjislacionin që rregullon procedurat tatimore në RSH, është përcaktuar institucioni publik në rolin e Agjentit Tatimor, përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e të ardhurave nga tarifa për shërbimet e radiokomunikimit në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t'u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit, mbështetur kjo në nenin 11/e, të Ligjit nr. 9975/2008. Në vijim, si dhe referuar Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Kryetarit të KD-së së AKEP, nr.30, datë 23.12.2014, *"Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit"*, i ndryshuar, është përcaktuar niveli minimal i tarifës së shërbimit

të radiokomunikimit, si dhe komisionet përkatëse të përftuar nga AKEP në funksionin e agjentit tatimor për mbledhjen e tarifës për shërbimet e radiokomunikimit.

2. Në pikën 6 të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar se AKEP-për shërbimet e kryera përfiton në masën 5% komision të vete llogaritur prej tij, mbi vlerën e tarifave të llogaritura, ndërkohë që transferon 95 % të vlerës në Buxhetin e Shtetit. Mbledhja dhe transferimi i tarifave dhe taksave në buxhetin e shtetit, është detyrë që e kryen agjenti tatimor, referuar përcaktimeve ligjore parashikuara në pikën 1.b), neni 5, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilave *agjenti tatimor është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat*.

3. Në vëmendje të sa më sipër, AKEP me VKD nr. 93, datë 10.12.2018, "*Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare*", ka sanksionuar ndër të tjera modalitetet dhe procedurat e përdorimit të këtij komisioni, duke konsideruar themelore tre kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (***Ligji nr.9975/2008).***

4. Në këtë kontekst, me VKD nr. 12, datë 14.09.2022, "Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe Projekt Buxhetin e vitit 2023 të AKEP", është vendosur se nga vlera 24.5 milion lekë e parashikuar të përftohet nga AKEP si Agjent Tatimor, për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e tarifës së radio komunikimit, vlera prej 14.7 milion lekë do të përdoren si shpërblim për vështirësi në punë për vitin 2023, për punonjësit e AKEP.

**Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se:**

5. Këshilli Drejtues i AKEP në referim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, duke analizuar nevojat, si dhe duke parë përparësitë për përdorimin e komisionit të përftuar si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radio komunikimit, vlerëson tërësisht legjitime dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi përdorimin në masën parashikuar në fondin e shpenzimeve administrative të AKEP të komisionit në fjalë, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë.

6. Përfshirja e gjithë punonjësve të AKEP për ushtrimin e detyrave dhe mbartjen e përgjegjësive të përcaktuara ligjërisht për agjentin tatimor, duke u bazuar në specifikën e tarifës për shërbimin e radio komunikimit, nuk mund të konsiderohet një veprim i thjeshtë llogaritës, por një procedurë e lidhur ngushtë me gjithë procesin e zbatimit të detyrave dhe ushtrimin e kompetencave nga strukturat e AKEP, në përputhje me ligjin nr. 9918/2008. Për këto arsye, zgjidhja me e mirë në funksion të arritjes në një nivel sa më të lartë të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa për shërbimin e radio komunikimit, është ndërthurja e detyrave funksionale të çdo punonjësi të AKEP sipas pozicionit të punës, me detyrat e parashikuara ligjërisht për agjentin tatimor. Në këtë mënyre edhe përgjegjësia për të siguruar një rol sa më aktiv, profesional dhe rezultativ të AKEP-it si agjent tatimor, unifikohet me përgjegjësinë e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore të çdo punonjësi.



[redacted]

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

**V E N D O S I:**


1. Përdorimin në vlerën prej 14.7 milion lekë të komisionit të përfituar si agjent tatimor në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2023, për punonjësit e AKEP.

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij Vendimi.

   Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1762/6 Prot. Tiranë, më 06.08.2023

# V E N D I M

**Nr. 8, datë 06.08.2023**

**PËR**

**"APLIKIMIN E SHTESËS MBI PAGË PËR POZICIONET E PUNËS QË NDJEKIN DHE ADMINISTROJNË SISTEMET INFORMATIKE NË AKEP BAZUAR NË VKM NR. 325, DATË 31.05.2023"**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Z. | Tomi | Frashëri | Kryetar |
| Znj. | Edlira | Dvorani | Anëtar |
| Znj. | Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| Z. | Lorenc | Bako | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 06.08.2023 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për "Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", me propozim të DT, DMKI, DBMF, DSHB shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Për aplikimin e shtesës mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023;**

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ***(ligji nr. 9918)***:

2. Pika 26, e lidhjes 3, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike";

3. Pika 1 e nenit 8 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar (ligji 10296/2010);

4. VKM nr.750, datë 01.12.2022 "Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023";

5. Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 16.06.2023 "Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023".

6. Rregullore e Brendshme për "Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare", miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP;

7. Memo Drejtoria Teknike nr.1762/2prot., datë 30.06.2023"*Kërkesë/Vlerësim mbi pozicionet e punës së DT që përfitojnë shtesë page sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 325, datë 31.05.2023 dhe nr. 1762/4prot, datë 25.08.2023 "Informacion shtesë në lidhje me memo nr. 1762/2prot, datë 30.06.2023";*

8. Memo Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit nr.1762prot.,datë 30.06.2023"*Kërkesë/Vlerësim mbi pozicionet e punës së DMKI që përfitojnë shtesë page sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 325, datë 31.05.2023 dhe nr. 1762/5prot, datë 25.08.2023"Informacion shtesë në lidhje me memo nr. 1762prot, datë 30.06.2023";*

9. Shkresë nr. 1849prot., datë 18.07.2023 drejtuar Departamentit të Administratës Publike "Për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023".

10. Shkresë kthim përgjigje e Departamentit të Administratës Publike me nr. 3851/1Prot., datë 01.08.2023 (*administruar në AKEP me nr. 1849/1prot., datë 03.08.2023.)*

**K Ë SH I LL I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,



[redacted]

**V Ë R E N:**

1. Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 *"Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"*, konktretisht përcaktimeve ligjore të pikës 26, të lidhjes 3, AKEP si Institucion në fushën e veprimit të këtij vendimi i lind detyrimi për aplikimin e shtesës në masën e përcaktuar për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për disa pozicione pune, të specifikuara në Vendim.

2. Për këtë qëllim bazuar në vlerësimin e realizuar nga 2 drejtoritë përkatëse të cilat administrojne sisteme (Drejtoria Teknike dhe Drejtoria MKI), AKEP ka hartuar shkresën (nr. 1849prot., datë 18.07.2023) drejtuar Departamentit të Administratës Publike "Për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023", në të cilën kërkon miratimin paraprak të shtesave respektive nga ky institucion, me qëllim zbatimin e tyre.

3. Strukturat përgjegjëse të AKEP në analizë edhe të sistemeve që menaxhohen prej tyre, kanë vlerësuar përgjegjësitë e punës dhe formimin profesional për çdo nëpunës në të cilin do të aplikohet shtesa mbi pagë, në raport me detyrimet që rrjedhin nga hyrja në fuqi e VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike".

4. Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 3851/1Prot., datë 01.08.2023 (administruar *në AKEPdatë 03.08.2023*) me lëndë "*Kthim përgjigje kërkesës për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr.325/2023*", komunikon se zbatimi i shtesave të përcaktuara në pikën 26, të lidhjes nr. 3, të VKM-së nr. 325/2023 bëhet rast pas rasti nga vetë institucionet, të cilët bëjnë vlerësimin nëse ndodhen në kushtet e përcaktuara në këtë pikë, pa marrë më parë miratimin e Departamentit të Administratës Publike.

5. Në vijim AKEP duke vlerësuar të drejtën legjitime për të aplikuar shtesa mbi pagë për pozicionet përgjegjëse për sistemet informatike në AKEP sipas formimit përkatës arsimor, ka hartuar projektaktin *"Për aplikimin e shtesës mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023"*.

6. Projektakti është hartuar në referencë të përcaktimeve ligjore pika 26, e lidhjes 3, të VKM nr.325/2023 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 16.06.2023 *"Për mënyrën e zbatimit të vendimit të këshillit të Ministrave nr. 325, datë* 31.05.2023" për pozicionet respektive të punës që administrojnë sisteme informatike në këto 2 Drejtori:

   a) Drejtoria Teknike është Njësia Organizative Përgjegjëse që administron sistemet informatike në AKEP, e cila përveç infrastrukturës fizike dhe virtuale është përgjegjëse për sigurinë kibernetike si dhe Infastrukturën kritike sipas përcaktimeve të VKM nr. 761, datë 12.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të



[redacted]

Ministrave nr. 553, datë 15.07.2020 "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit".

- ✓ Sistemet kryesore të infrastrukturës kritike përfshijnë:
  - Sistemin CCTLD.al;
  - Portabilitetin e numrit;
  - Sistemin e Përqëndruar i Informacionit;
  - Sistemin e menaxhimit/monitorimit të frekuencave (Sistemi SPECTRA);
  - e-Aplikime (ish-Revzone).
- ✓ Sistemet kryesore të infrastrukturës fizike dhe virtuale përfshijnë:
  - Server fizik me Platformat e Virtualizimit;
  - Server Backup;
  - Disaster Recovery Site (DRS);
  - Pajisjet kompjuterike dhe ndihmëse;
  - Network/WiFi.
- ✓ Sistemet kryesore të sigurisë kibernetike përfshijnë:
  - Firewall;
  - SIEM;
  - SMA;
  - Antivirus.
- ✓ Sisteme të tjera informatike:
  - Access Control
  - Sistemi i menaxhimit të alerteve në dhomën e serverave (sensorët)
  - Sistemi i kamerave
  - Domain Controller
  - Active Directory
  - Shërbimi e-Mail (shërbim cloud – Office365)
  - Azure
  - Serverat Virtualë të Financës etj.

b) Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit është Njësia Organizative Përgjegjëse që administron sistemin teknik konkretisht Sistemin Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave në AKEP për verifikimin e përdorimit të frekuencave me autorizimin përkatës, zbatimit të kushteve Autorizimeve Individuale të lëshuara si dhe identifikimin e burimeve të dëmshme të interferencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, në përputhje me rekomandimet e ITU, i cili përmban stacionet monitoruese si:

- 1 Qendër Kontrolli Kryesore (MCC) – Tiranë,
- 2 Stacione fiks monitorimi (RFMS) – Pinet, Krujë,
- 5 Stacione të thjeshtë monitorues të komanduar në distance (SRFMS) – Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Fier,
- 2 Stacione të lëvizshëm monitorimit (MMS),
- 1 Stacion monitorues i transportueshëm (TMS) si edhe;
- Qendrën Kombëtare e Lëvizshme e Monitorimit të Cilësisë së Shërbimit (QoS) si dhe sistem serverash për mbledhjen, administrim, përpunimin e të dhënave në kontrollin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në përdorimin e teknologjive 2G, 3G, 4G dhe së shpejti dhe për teknologjinë 5G.

Konkretisht, sistemi ***"Spectrum Monitoring System -Scorpio TCI " dhe "Rohde & Schwarz ARGUS"*** janë dy sisteme të rëndësishme për monitorimin e spektrit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë. Këto sisteme ndihmojnë DMKI (Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së) të mbledhë dhe menaxhojë informacionin e nevojshëm për të siguruar përdorimin efikas të spektrit të frekuencave dhe për të koordinuar frekuencat në territorin e vendit.

Administrimi i databazës qëndrore të sistemeve të monitorimit të frekuencave si dhe operimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit (software) të monitorimit të spektrit të frekuencave janë infrastruktura të cilat menaxhohen vetëm nga DMKI, kjo për shkak të specifikës së të dhënave që ato ruajnë dhe përpunojnë në kohë reale, për të cilat kërkohet informacion.

7. Për këtë qëllim bazuar në përcaktimet e mësipërme ligjore i cili kushtëzon fitimin e kësaj të drejte përmes plotësimit të dy kushteve bazë, DT dhe DMKI morën në shqyrtim pozicionet e punës respektive që plotësojnë fushën e përgjegjësisë sipas përshkrimit të punës apo detyrave funksionale, duke parashtruar të detajuara sistemet informatike që ndjekin dhe administrojnë rast pas rasti.

8. Sektorët që administrojnë sistemet e sipërcituara dhe aplikohet kjo shtesë janë:

a) **Sektori i Numeracionit, Sigurisë së Rrjeteve, Infrastrukturës dhe IT (DT)** i cili është sektori bazë i Drejtorisë Teknike, pasi menaxhon pjesën më të madhe të sistemeve informatike të institucionit të përshkruara në pikën 6/a të këtij Vendimi. Pozicionet e punës brenda këtij sektori që përmbushin kushtet sipas detyrave funksionale që ushtrojnë janë:

**Përgjegjës i sektorit të numeracionit, sigurisë së rrjeteve, infrastrukturës dhe IT,** i cili kujdeset për monitorimin dhe menaxhimin e rrjetit fizik dhe virtual, infrastrukturës fizike dhe virtuale, infrastrukturës DRS, CCTLD.al, Portabiliteti i numrit, ATLAS, e-Aplikime, Sistemit Antivirus dhe SIEM me qëllim garantimin e sigurisë së rrjetit të AKEP, kontrollet në të gjitha sistemet informatike, koordinimi i stafit për të përcaktuar objektivat dhe prioritetet teknike.

**Specialist i çështjeve të faciliteteve shoqëruese dhe infrastrukturës** i cili kujdeset për monitorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës fizike dhe virtuale, kontrollet në të gjitha gjithë serverat e AKEP, Disaster Revory Site dhe menaxhimi i SPI - ATLAS.

**Specialist IT dhe shërbimeve broadband,** i cili kujdeset për menaxhimin dhe monitorimin e të gjithë rrjetit të internetit në AKEP, pajisjet e shpërndarjes, pajisjet kompjuterike dhe ndihmëse, dhoma e serverave, menaxhimi i sistemeve të ndryshme informatike etj.

b) **Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së (DT),** i cili nëpërmjet sistemit SPECTRA dhe SpaceCom administron databasën e frekuencave, të cilat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore, siç dhe përcaktohet në ligjin nr. 9918, i ndryshuar.

Meqënëse sistemi për administrimin e frekuencave(SPECTRA) është specifik për llojin e të dhënave që ai ruan, duhet të administrohet nga punonjës me njohuri të thelluara për frekuencat. Duke marrë parasysh këtë fakt, kjo platformë i ka kaluar nën administrim

**Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit dhe Koordinimit të SRF** i cili është përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave, ndërfaqes së përdoruesit, vizualizimit të të dhënave etj.

c) **Sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SRF (DMKI)** ndër detyrat kryesore të të cilit janë:

- *Mirëmbajte, administrim dhe operim i sistemeve informatike Spectrum Monitoring System – Scorpio Client , Rohde & Schwarz ARGUS.*

Funksionet kryesore të këtyre programeve janë administrimi i bazës së të dhënave të frekuencave, koordinimi dhe Inspektimi i frekuencave, analiza e interferencave, administrimi i planit kombëtar të frekuencave, koordinimi ndërkombëtar dhe inspektimi i caktimeve të frekuencave si dhe funksione të tjera që lidhen me administrimin dhe vlerësimin e brezave të frekuencave.
Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) realizojnë monitorimin dhe analizimin e te dhënave të spektrit të frekuencave në brezin 20 – 3000 MHz nëpërmjet software-it të Monitorimit ARGUS.
Spectrum Monitoring System – Scorpio kryen monitorimin periodik me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit të frekuencave RFMS dhe SRFMS me qëllim ofrimin e të dhënave të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, analizimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, ofrimin e informacioneve të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vëndeve fqinje në eleminimin e interferencave të dëmshme.

- *Monitorimi i cilësisë (QoS)*

Ndër proceset që administron Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së pjesë e DMKI është dhe analizimi i Treguesve të Cilësisë së Shërbimit (QoS) i cili kryhet nga Specialisit i treguesve QoS.

Për analizimin e treguesve të cilësisë së shërbimit (QoS), AKEP ka në administrim Qendrën Kombëtare të Levizshme të Monitorimit të Cilësisë së Shërbimit si dhe sistem serverash për mbledhjen, administrimin, përpunimin e të dhënave në kontrollin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në përdorimin e teknologjive 2G, 3G, 4G dhe së shpejti dhe për teknologjinë 5G.

Mirëfunksionimi i sistemeve në fjalë, referuar karakteristikave strukturore të AKEP, por dhe kompetencave të sanksionuara në përshkrimin e punës, është përgjegjësi direkte e punonjësve të DMKI, Sektorit te Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SRF, dhe konkretisht të *Drejtorit të Drejtorisë, Përgjegjësit të Sektorit, Specialistit të Monitorimit të Cilësisë (QoS) dhe Specialistit të Sistemit të Monitorimit të SRF.*

9. Punonjësit e përzgjedhur për aplikimin e shtesës në pagë plotësojnë kriteret e përmendura në pikën 26, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023, bazuar në diplomën universitare në degët përkatëse si dhe përshkrimin e vendit të punës.

10. Pika 26 e VKM- së nr. 325, datë 31.05.2023, përcakton se shtesa në pagë jepet përkatësisht në masën:
    - *60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Specialist";*
    - *50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Përgjegjës Sektori";*
    - *70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Drejtor Drejtorie" apo "Drejtor i Përgjithshëm.*

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 114 dhe në pikën 1, të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

## VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e shtesave në pagë sipas Lidhjes nr. 1 *"Lista emërore e pozicioneve të punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP dhe aplikohen shtesat në pagë sipas VKM- së nr. 325, datë 31.05.2023".*
2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Shtesa në pagë për vitin 2023 të përballohet nga fondi i shpenzimeve të AKEP, zërat "Shpenzime për paga e shtesa" si dhe "Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore", me efekte financiare duke filluar nga data 1 Prill 2023 sipas përcaktimeve të pikës 7, Kreu IV, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| Kryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| **Tomi Frashëri** | **Edlira Dvorani** | **Ketrin Topçiu** | **Lorenc Bako** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 2130 Prot. Tiranë, më 18.10.2023

# V E N D I M

**Nr. 12, datë 18.10.2023**

**Për**

***"Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për "NJË NDRYSHIM TË VKM NR. 750, DATË 1.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023"***

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---|---|---|
| Z. | Tomi Frashëri | Kryetar |
| Znj. | Edlira Dvorani | Anëtar |
| Z. | Armer Juka | Anëtar |
| Z. | Bleron Dokle | Anëtar |
| Z. | Lorenc Bako | Anëtar |

dhe sekretare znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 18.10.2023, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme "Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të AKEP", miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.2.2017, me propozim të Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për "NJË NDRYSHIM TË VKM NR. 750, DATË 1.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023.***

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3, e nenit 114 dhe nenit 115, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;

2. Ligji Nr.46/2015, *"Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë"*;

3. Pika 1, e nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar;

4. Ligji nr. 34/2023, *"Për një ndryshim në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj"*, i ndryshuar;

5. VKM nr.750, datë 01.12.2022, *"Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023"*;

6. VKM nr. 325, datë 31.05.2023, *"Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"*;

7. VKM- së nr. 326, datë 31.05.2023, *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"*;

8. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16 datë 16.06.2023, *"Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023"*.

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për *"Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023"* (projekvendimi);
2. Relacioni mbi projektvendimin (***Relacioni***);

## VËREN:

1. Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 117, të ligjit nr. 9918/2008, paraqitet për miratim pranë këshillit drejtues të AKEP, projektvendimi për *"Propozimin Ministrit të infrastrukturës dhe energjisë për "Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022, për miratimin e buxhetit per AKEP për vitin 2023"*, ndërkohë që më poshtë listohen aktet ligjore dhe nënligjore, hyrja në fuqi e të cilave reflekton ndryshime me efekt ndjeshëm rritës të zërit të shpenzimeve për pagat e punonjësve të AKEP.

2. Ligji nr. 34/2023, *"Për një ndryshim në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj"*, përmban përcaktimin me efekt rritës të masës së pagës mujore të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe me të njëjtin efekt të anëtarëve të Këshillit Drejtues të institucionit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 *"Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendesministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"*, përcakton strukturën e re të pagave, nivelet dhe shtesa të tjera mbi pagë, ndër të tjera edhe për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, duke përfituar rritje page, konkretisht, 68 nëpunës civil dhe 4 funksionarë të kabinetit të Kryetarit të AKEP.

4. VKM nr. 326, datë 31.5.2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"*, ndërkohë që AKEP ka në strukturën organizative 8 punonjës mbështetës, të cilët përfitojnë rritje page nga ndryshimet e mësipërme.

5. Gjithashtu, të dy vendimet e lartpërmendur të Këshillit të Ministrave, parashikojnë shtesa page për vjetërsi në punë, apo për vështirësi në vendin e punës. Në këtë kontekst Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar kreu llogaritjet në listëpagesat e muajit qershor dhe rishikoi listëpagesat e muajit prill dhe maj, si dhe kreu deklarimet përkatëse në sistemin e tatimeve për ndryshimet e pagave.

6. Vlera e rritjes së fondit të pagave llogaritet të jetë në vlerën prej 14,830,373 lekë fond page, si dhe Zëri shpenzime për sigurinë shoqërore dhe shëndetësore në vlerën e 2,411,758 lekë. Në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, AKEP e konsideron determinante rishikimin e strukturës së fondit të shpenzimeve për vitin 2023, konkretisht, duke alokuar kursimet nga:
   a. *procesi i prokurimeve në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën e 2,240,000 lekë;*
   b. *zëri i shpenzimeve për shërbime në vlerën e 15,002,131 lekë, e cila rrjedh nga kursimet nga prokurimet e zërave të shërbimeve, kryesisht të platformave teknologjike;*
   c. *zbritja e kontributit për vitin 2023 në organizata ndërkombëtare, si BEREC, ku, nga kontributi i derdhur në vitet e mëparshme janë akumuluar një tepricë, kështu që për vitin 2023 nuk kemi pagesë;*
   d. *si dhe kursimet nga zërat e shpenzimeve të tjera.*
7. Kjo, rrjedhimisht sjell domosdoshmërinë e hartimit dhe përcjelljes së këtij akti pranë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim ushtrimin e kompetencave kushtetuese sa i përket ndryshimit të Strukturës së Fondit të Shpenzimeve Administrative të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, miratuar me VKM nr. 750, datë 1.12.2022, *"Miratimin e Buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023"*.
8. Rishpërndarja e fondit të shpenzimeve, sikurse parashtrohet në Lidhjen 1, reflekton mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara, sipas burimeve ligjore të financimit për AKEP, të parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore e më konkretisht, nenin 119, të ligjit nr. 9918/2008, dhe nenin 27, të ligjit nr. 46/2015, që realizohet nëpërmjet zërit të pagesave për AKEP të miratuara për vitin 2023.
9. Të ardhurat e parashikuara sipas burimeve të financimit, janë llogaritur në të njëjtin nivel me atë të fondit të shpenzimeve administrative në total, në përputhje me statusin ligjor të AKEP si person juridik, publik, jo buxhetor dhe i pavarur, i krijuar me ligj të veçantë.

[redacted]



[redacted]

10. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin e Këshillit Drejtues për *"Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për "Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023"*, jep sqarime të hollësishme ligjore dhe financiare mbi të gjithë zërat e fondit të shpenzimeve të parashikuara dhe projektbuxhetin e vitit 2023.

**PËR KËTO ARSYE:**

Pasi e gjen projektaktin *"Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për "Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023"*, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të listuara në pikën "Baza Ligjore", përshirë dhe dispozitat përkatëse rregullatore të Rregullores së Brendshme të AKEP;

**VENDOS:**

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve administrative të parashikuara, në shumën 381,500,000 lekë (treqind e tetëdhjetë e një milion e pesëqind mijë) lekë, të ndarë sipas zërave që paraqiten në Lidhjen 1, bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Fondi i shpenzimeve administrative të rishikuar për vitin 2023, sipas pikës 1 dhe lidhjes 1 shoqëruese të vendimit, t'i dërgohen Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim propozimin pranë Këshillit të Ministrave me qëllim ndryshimin e VKM nr. 750, datë 1.12.2022, *"Miratimin e buxhetit për AKEP, për vitin 2023"*.

3. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e procedurave deri në miratimin e fondit të shpenzimeve administrative për vitin 2023 të AKEP.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 1444/3 Prot.

Tiranë, më 18.10.2023

# V E N D I M

**Nr. 13, datë 18.10.2023**

**PËR**

**"MËNYRËN E PËRDORIMIN NGA AKEP TË KOMISIONIT QË DO TË PËRFITOHET, SI AGJENT TATIMOR PËR VITIN 2024"**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---|---|---|
| Z. | Tomi Frashëri | Kryetar |
| Znj. | Edlira Dvorani | Anëtar |
| Z. | Armer Juka | Anëtar |
| Z. | Bleron Dokle | Anëtar |
| Z. | Lorenc Bako | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 18 / 10 / 2023, konform procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për "*Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare*", miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor për vitin 2024;**

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 3, e nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, *"Për komunikimet elektronike në RSH"* ***(ligji9918/2008);***

[redacted]

2. Pika 4, e nenit 2, pika 3 e nenit 8, si dhe gërma e), e nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar. ***(ligji nr. 9975/2008)***;

3. Pika 1.b) e nenit 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" ***(ligji nr. 9920/2008)***;

4. Pika 1 e nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar ***(ligji 10296/2010);***

5. Pika 3 dhe pika 6 e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe AKEP, nr. 30, datë 23.12.2014, "*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit*", i ndryshuar;

6. Seksioni 1 i Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat kombëtare", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 27 datë 16.12. 2014.

7. VKD nr. 93, datë 10.12.2018 "Për vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare",

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projektvendimit të përgatitur nga DBMF (***Relacioni***);
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## VËREN:

1. AKEP, bazuar në legjislacionin që rregullon procedurat tatimore në RSH, është përcaktuar institucioni publik në rolin e Agjentit Tatimor, përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e të ardhurave nga tarifa për shërbimet e radiokomunikimit në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t'u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit, mbështetur kjo në nenin 11/e, të ligjit nr. 9975/2008.

2. Në vijim, si dhe referuar Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Kryetarit të KD-së së AKEP me nr.30, datë 23.12.2014, "*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit*", i ndryshuar, është përcaktuar niveli i tarifës së shërbimit të radiokomunikimit, si dhe komisionet përkatëse të përftuar nga AKEP në funksionin e agjentit tatimor për mbledhjen e tarifës për shërbimet e radiokomunikimit.

[redacted]

3. Në pikën 6 të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar se AKEP për shërbimet e kryera përfiton në masën 5% komision të vetë llogaritur prej tij, mbi vlerën e tarifave të llogaritura dhe arkëtuara, ndërkohë që transferon 95 % të vlerës në Buxhetin e Shtetit. Mbledhja dhe transferimi i tarifave dhe taksave në buxhetin e shtetit, është detyrë që e kryen agjenti tatimor, referuar përcaktimeve ligjore parashikuara në pikën 1.b), neni 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilave *agjenti tatimor është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat.*

4. Në vëmendje të sa më sipër, AKEP me VKD nr. 93, datë 10.12.2018, "*Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare*", ka sanksionuar ndër të tjera modalitetet dhe procedurat e përdorimit të këtij komisioni, duke konsideruar themelore tre kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (***Ligji nr.9975/2008).***

5. Përgjegjësia e AKEP si Agjent Tatimor është e lidhur me zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 4, të nenit 2, të ligjit nr. 9975, "Për taksat kombëtare", të cilat në rastin konkret janë:
   a. llogaritja e tarifës për shërbimin e radiokomunikimit;
   b. arkëtimi i lyre;
   c. transferimi në llogarinë e Buxhetit të Shtetit i të ardhurave të vjela nga arkëtimi tarifës.

6. Komisioni si Agjent Tatimor në masën 5 %, AKEP ka tagër ta vetëllogarisë në burim, pra menjëherë pas mbledhjes se tyre, si dhe duhet ta përdorë konform pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 9975 dhe pikës 1.3 seksioni I të Udhëzimit nr. 26, ku përcaktohet se komisionet e përfituara përdoren:
   a. Në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
   b. Në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
   c. Për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

7. Këshilli Drejtues i AKEP si organ drejtues ka të drejtë për të vendosur mënyrën, përdorimin me eficincë dhe në bazë të nevojave duke marrë parasysh dhe përcaktimet ligjore dhe destinacionin e përdorimit të këtij komisioni. Sipas dispozitave, referuar me lart dhe dispozitave të ligjit nr. l0296, date 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Këshilli Drejtues është titullar i njësisë publike.

8. Në kuptim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.l0296: "*...Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike,*

*në mënyre të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficencë ...*", përcaktohet qartë kompetencat që i lindin Këshillit Drejtues për të përdorur këtë fond sipas dispozitave në fuqi.

**Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se:**

9. Sipas pikës 3 të Udhëzimit nr. 30, datë 23.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit", i ndryshuar, AKEP ngarkohet të veprojë si agjent tatimor dhe për rrjedhojë duhen marrë masat organizative më qëllim përmirësimin e kushteve të punës të AKEP, në funksion të mbledhjes të tarifës për shërbimin e radiokomunikimit.

10. Përgjegjësitë dhe detyrat e AKEP si agjent tatimor dhe përdorimi i komisionit të përfituar sipas pikës 6 të Udhëzimit nr. 30, datë 23.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit", i ndryshuar, burojnë nga përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim, konkretisht në pikën 4, neni 2, dhe pikën 3, neni 8, të ligjit nr. 9975, si dhe seksioni 1.3, Udhëzim nr. 27, datë 16.12.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" .

11. E drejta e Këshillit Drejtues për të vendosur mënyrën, përdorimin me eficiensë dhe në bazë të nevojave, duke marrë parasysh edhe përcaktimet ligjore dhe destinacionin e përdorimit të këtij komisioni, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të veprimtarisë si agjent tatimor të AKEP, bazohet në pikën 1 dhe 3, neni 114, si dhe bazuar në pikën 22, të nenit 4, të ligjit nr. l0296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë e përcaktojnë kufijtë e përdorimit të nivelit të shpenzimeve.

12. Në kuptim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. l0296, "... *Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyre të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë ...*", përcaktohen qartë kompetencat që i lindin Këshillit Drejtues për të administruar këtë fond sipas dispozitave në fuqi.

13. Me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 93, datë 10.12.2018 "Për vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përfituar nga AKEP në cilësinë e tij si Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare", është vendosur konkretisht, miratimi i rregullave për përcaktimin, menaxhimin dhe miradministrimin e komisionit të përfituar nga AKEP, në cilësinë e tij si agjent tatimor për mbledhjen e tarifave kombëtare.

14. Në vijim, me VKD nr. 93, është vendosur gjithashtu se Kryetari i Këshillit Drejtues, në cilësinë e tij si Drejtues Ekzekutiv i AKEP, i propozon KD shumën e komisionit të përfituar nga AKEP në cilësinë e tij si agjent tatimor për mbledhjen e tarifave kombëtare dhe, pas miratimit nga KD, Kryetari, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, ngarkohet të ndjekë procedurat zbatuese ligjore e nënligjore. KD është përgjegjës për të përcaktuar procedurën e miratimit të përdorimit të këtij fondi, përfshirë raportet e përdorimit, afatet/kohën se kur duhet të kryhen investimet/marrë punonjës të rinj apo shpërndahen komisionet e përfituar për vështirësi pune, në cilësinë e AKEP si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës kombëtare të radio komunikimit.

15. Këshilli Drejtues i AKEP, në referim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, si dhe duke analizuar nevojat dhe duke parë përparësitë për përdorimin e komisionit të përftuara si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radiokomunikionit, vlerëson tërësisht legjitime dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi përdorimin e komisionit në fjalë, me qëllim përmirësimi të kushteve të punës të punonjësve dhe institucionit si dhe motivimit të punonjësve në kryerje e detyrës.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1, të nenit 114, në pikën 1, të nenit 115, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

**V E N D O S I:**

1. Komisionet që parashikohen për t'u përfituara nga AKEP si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radiokomunikimit, për vitin 2024, të përdoren:

    a. për mekanizimin, informatizimin dhe përmirësimin e kushteve të punës të AKEP, në masën 40 % të vlerës së parashikuar;
    b. në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në masën 60 % të vlerës së parashikuar.

2 Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të pasqyrojë këtë vendim në projektbuxhetin e vitin 2024.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

[redacted]